



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Ekonomi
Ndërmarrjeje”**

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Dr. ERMIRA QOSJA
Dr. RINALDO MUÇA**

Korrik / 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bsc në “Ekonomi Ndërmarrjeje”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Ekonomi Ndërmarrjeje
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 567, datë 27.08.2004
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë nga MASH Nr. 6959/3, datë 15.02.2013
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 213, datë 14.11.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 340, datë 16.09.2015
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha italiane
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Universitetin “Aldo Moro” i Barit, Itali
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Ekonomi Ndërmarrjeje
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	24 PAE / 7 PAK
18	Numri i studentëve:	72 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 567, datë 27.08.2004. Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky Universitet ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.112, date 15.12.2017, me kohëzgjatje 6 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2023.

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, është i organizuar në 4 fakultete:

1. Fakulteti i Farmacisë;
2. Fakulteti i Mjeksisë;
3. Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale;
4. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” licensuar me VKM Nr. 567, datë 27.08.2004 si diplomë universitare në “Ekonomi dhe administrim ndërmarrjeje”, 3 vite akademike. Me shkrese Nr. 6959/3 prot, datë 15.02/2013 të MASH është ndryshuar vetëm emërtimi i programit në "Ekonomi Ndërmarrjeje" pa patur asnjë ndryshim në brendi të programit. Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale dhe është program i përbashkët studimi dhe ofrohet së bashku me Universitetin “Aldo Moro” të Barit, në përputhje me marrëveshjen që funksioni që nga vitit 2004 mes dy institucioneve. Programi është akredituar për herë të parë, me UMASH Nr. 340, datë 16.09.2015, në bazë të vendimit Nr.40, datë 05.05.2015 të Këshillit të Akreditimit.

Në fund të studimeve, lëshohet një diplomë e përbashkët nga Universiteti i Barit “Aldo Moro” dhe Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”. Duhet theksuar që programi “Ekonomi Ndërmarrjeje” është akredituar gjithashtu në Universitetin e Barit nga Ministria e Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimit në Itali.

Ky program synon të ofrojë formim profesional dhe të përgatisë punonjësit e ardhshëm për sektorin publik dhe privat. Formimi i profesionistëve me njohuri dhe aftësi për të marrë vendime, analizuar dhe zgjidhur probleme në situata të vështira në përputhje me strategjitë e zhvillimit të institucioneve ku ata do punojnë e kontribuojnë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përshtatjes së moduleve me legjislacionin dhe kontekstin shqiptar në të cilin ndërmarrja ushtron aktivitetin e saj. Diploma e përbashkët dhe pjesëmarrja në mësimdhënie e pedagogëve garanton cilësinë e procesit, por në të njëjtë kohë bën që të diplomuarit të jenë konkurrues dhe të pranueshëm në tregun evropian.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimi i Këshillit të Akreditimit, mbështetur në Vendimin nr. 40, datë 05.05.2015 ishte: *“Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” të konsiderojë një shpërndarje më të balancuar të ngarkesës mësimore, përgjatë vitit akademik, për studentët e këtij programi studimi¹.”*

Pas konsultimit të dokumentacionit të depozituar në ASCAL nga UKZKM dhe vizitës inspektuese në terren, GVJ konstaton për përmbushjen e rekomandimeve, lënë nga akreditimi i kaluar, sa vijon:


Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje”, hapur me Vendimin nr. 567, datë 27.8.2004, ndryshuar me Vendimin nr. 6959/3, datë 15.02.2013² dhe akredituar me Vendimin nr. 340, 16.05.2015³, ka **përmbushur kryesisht** rekomandimet e Këshillit të Akreditimit, në mënyrë të veçantë atë për të garantuar një shpërndarje më të ekuilibruar të ngarkesës mësimore gjatë vitit akademik.

Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët, ata u shprehen që ngarkesa javore e tyre shpesh është e pabalancuar. Në portalin e tyre ata përditësohen me orarin dhe ngarkesën javore. Gjatë vizitës kërkuam të ngarkohej në sistemin e ASCAL orari mësimor, por institucioni nuk e ka përditësuar ende. Duhet evidentuar që situata COVID-19, sipas koordinatorës dhe studentëve, e ka lehtësuar organizimin e javës mësimore për studentët, për shkak të zhvillimit *online* të mësimin, por kjo vetëm për dy vitet e fundit akademike.

¹ Evidencë dok. nr 4 nga arkiva: “Vendim për Akreditimin Periodik të Programit të Përbashkët Bachelor në Ekonomi Ndërmarrje midis UKZKM dhe Universitetit ‘Aldo Moro’ të Barit”.

² Evidencë dok. nr 2 nga arkiva: “Shkresë – Përgjigje lidhur me ndryshimin e emrit të programit të studimit Bsc Ekonomi dhe administrim ndërmarrje në Bsc Ekonomi ndërmarrje”.

³ Evidencë dok. nr 3 nga arkiva: “Urdhër për Akreditimin Periodik të Programit të Përbashkët Ekonomi Ndërmarrje”.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Ermira Qosja dhe Dr. Rinaldo Muça. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” të ofruar nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm⁴, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2-ditore në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, u realizua gjatë datave 26-27 Maj, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë ditëve të vizitës, në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësat e Departamenteve dhe Dekanin e FSHEPS, Grupin e vetëvlerësimit, Stafin akademik të programit të studimit, Stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së këshillimit të karrierës, si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje”, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse.

Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 01.07.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 38 / 12 Prot, datë 01.07.2021. Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, përcjell në ASCAL më datë 12 Korrik, me anë të shkresës me Nr. 35/1 Prot, datë 09.07.2021, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

⁴ Evidencë nr. 1, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.

1. Observacion nr. 1 – Referenca: Standardi I.5, Kriteri 3

Raporti i përfshirë në shkresën e sipërcituar është dërguar jashtë afateve për depozitim të informacionit. Subjektit iu kërkua ky raport nga grupi i ekspertëve edhe përgjatë vizitës në terren, por edhe pasi u përditësua dosja në sistemin e-ASCAL, materiali nuk u ngarkua në të. Rrjedhimisht, **ky observacion nuk pranohet.**

2. Observacioni nr. 2 – Referenca: Standardi II.3, Kriteri 6

Sugjerimet e ekspertëve po implementohen nga subjekti, rrjedhimisht konsiderohen të pranuar. **Nuk ka nevojë për qëndrim nga ana e GVJ-së.**

3. Observacioni nr. 3 – Referenca: Standardi II.4, Kriteri 1

Ngarkesa mësimore totale e programit të studimit është 4.700 orë, në tejkalim të normës ligjore që përcaktohet 1.500 orë/vit, pra 4.500 orë për të gjithë programin e studimit. Rrjedhimisht, pavarësisht kërkesave për lëshimin e titullit të përbashkët apo objektivave të subjektit, për aq kohë sa ligji nuk parasheh përjashtime nga norma e sanksionuar, observacioni vjen sërish në kundërshtim me ligjin e për rrjedhojë **nuk mund të pranohet.**

4. Observacioni nr. 4 – Referenca: Standardi II.4, Kriteri 4

Në argumentin e subjektit nuk është sqaruar apo reflektuar mbi vlerësimet e grupit të ekspertëve për këtë kriter, ku citohet se nuk është e qartë se si ndahen leksionet dhe seminarët apo si bëhet vlerësimi i studentëve në programin e studimit. Për sa kohë që sqarimi i subjektit nuk sjell asgjë të re, **observimi nuk e ndryshon qëndrimin e GVJ-së për këtë kriter.**

5. Observacioni nr. 5 – Referenca: Standardi III.7, Kriteri 2

Sugjerimet e ekspertëve po implementohen nga subjekti, rrjedhimisht konsiderohen të pranuar. **Nuk ka nevojë për qëndrim nga ana e GVJ-së.**

6. Observacioni nr. 6 – Referenca: Standardi IV.1, Kriteri 1

Subjekti ka reflektuar, duke dërguar CV-në e Dekanit të Fakultetit. Gjithsesi vijon të mungojë CV e koordinatorës së programit, e përditësuar. Sikurse shprehur në kriter, këto CV gjenden *online*. **Nuk ka nevojë për qëndrim nga ana e GVJ-së.**

7. Observacioni nr. 7 – Referenca: Standardi IV.1, Kriteri 1

Sikurse theksuar edhe në vlerësimin e këtij kriteri nga GVJ, nga dy dosje fizike, të përzgjedhura rastësisht për vlerësim, jo i gjithë dokumentacioni ishte i përditësuar dhe/ose i noterizuar, sikurse janë kërkesat ligjore. Në dosjet elektronike, sikurse është konstatuar edhe në vlerësimin e kriterit, gjendet vetëm një pjesë e dokumentacionit, që është konfirmuar edhe nga subjekti në observacionin në fjalë. Plotësimi elektronik i të dhënave sugjerohet nga GVJ si një mënyrë më e mirë për të menaxhuar cilësisht burimet njerëzore të programit. Observacioni nuk ka sjellë informacion shtesë për këtë aspekt, rrjedhimisht **nuk ka nevojë për ndryshim qëndrimi nga ana e GVJ-së.**

8. Observacioni nr. 8 – Referenca: Standardi IV.2, Kriteri 2

Në përmbajtje të këtij observacioni janë një sërë çështjesh, adresuar specifikisht si vijon:

- a) Në observacion thuhet se *“Rregullorja e Brendshme Institucionale, së cilës i referohet Rregullorja mbi Procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, është në fakt Rregullorja*

e Fakultetit që ofron programin e studimit” dhe se ky dokument është depozituar në sistemin e-ASCAL. Në fakt, Rregullorja për Menaxhimin e BNJ, sikurse e ka të cituar në titullin e saj, por edhe në brendi kur shtjellon procedurat, është një rregullore në nivel Universiteti, pra ajo rregullon menaxhimin e BNJ në rang universitar. Për këtë arsye, vetë hartuesit e kësaj rregulloreje, kanë parashikuar në paragrafin 9 të saj, që për aq sa nuk mbulohet nga rregullorja në fjalë, mund të referohet **Rregullorja Institucionale e Fondacionit “Zoja e Këshillit të Mirë”**. Pikërisht për këtë Rregullore Institucionale e ka fjalën GVJ në vlerësimin që i bën kriterit, sepse kjo rregullore nuk gjendet në dosjen elektronike në sistemin e-ASCAL. Ftojme observuesit e kësaj pike të lexojnë me kujdes Rregulloren e Menaxhimit të BNJ. **Observacioni nuk pranohet.**

- b) Lidhur me mungesën e depozitimit të Kodit Etik, theksuar në observacion se nuk është kërkuar nga GVJ, theksojmë se: b.1) depozitimi i setit të plotë të materialeve që kërkohen për vlerësimin e suksesshëm të kriterëve është detyrë primare e vetë institucionit që kërkon të ri/akreditohet, dhe; b.2) gjatë vizitës në terren, GVJ i kërkoi subjektit të depozitonte të gjitha materialet që i gjykonte të nevojshme për një vlerësim të plotë dhe objektiv, përveç një sërë materialesh nominale që u kërkuan në mënyrë eksplicite nga ekspertët. Rrjedhimisht, **observacioni nuk pranohet.**
- c) Lidhur me pjesën e tretë të këtij observacioni, ku: “detyrat e personelit akademik shtjellohen shumë qartë në Ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, rrjedhimisht nuk ka pse të specifikohen në shpallje”, GVJ vëren sërish se hartuesit e observacionit duhet të studiojnë me kujdes Rregulloren e menaxhimit të BNJ të UK ZKM. Vetë rregullorja kërkon që shpallja të përmbajë një sërë elementësh që e detajojnë ligjin dhe aktet nënligjore, të cilët në fakt nuk janë respektuar në njërin nga shpalljet për vende të lira pune, që institucioni solli si ilustrim për vlerësimin e këtij kriteri. Një qëndrim i tillë i grupit të observimit zhvlerëson rregullat që institucioni ka vendosur vetë për rekrutim. **Observacioni nuk pranohet.**
- d) Përcjellja e dokumentacionit për rekrutim tek Dekani i njësisë kryesore që ofron programin e studimit nuk parashikohet në rregullore dhe njëkohësisht nuk është praktikë standarde pune, sikurse është theksuar edhe në vlerësimin e këtij kriteri. Mbledhja e dokumentacionit, sistemimi i tij dhe vlerësimi paraprak nëse dokumentacioni i përcjellë nga kandidati potencial është i plotë dhe konform afateve e kërkesave formale, nuk është detyrë e nivelit të Dekanit, por e specialistëve të Burimeve Njerëzore. Nëse Dekani ka dëshirë të angazhohet edhe në procedura të tilla burokratike, sugjerohet përcaktimi në rregullore i strukturës që mbledh aplikimet. Sikurse theksuar në RVJ për këtë kriter, mungojnë strukturat përgjegjëse për këto hallka të procesit të rekrutimit. **Observacioni edhe mund të pranohet, duke ngarkuar Dekanin me mbledhjen dhe sistemimin e dosjeve të kandidatëve për staf akademik.**

9. Observacioni nr. 9 – Referenca: Standardi IV.1, Kriteri 3

GVJ fton grupin e observuesve të japin referencat konkrete se ku konkretisht në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në Statutin Institucional të UK ZKM përcaktohen strukturat përgjegjëse për hallkat e procesit të rekrutimit, sikurse parashtruar në Rregulloren e menaxhimit të BNJ në këtë institucion. GVJ, sikurse theksuar edhe në RVJ me referenca konkrete, pas shqyrtimit të imtësishëm të akteve ligjore, nënligjore e Statutit institucional, nuk ka gjetur gjurmë të këtyre strukturave. **Observacioni nuk pranohet.**

10. Observacioni nr. 10 – Referenca: Standardi IV.2, Kriteri 1

Neni i Rregullores së menaxhimit të BNJ, që përpqet të rregullojë mënyrën e kryerjes dhe pagesës së orëve shtesë të realizuara nga punëmarrësi, duhet të ketë një referencë konkrete në Kodin e Punës apo një akt ligjor/nënligjor të ngjashëm. GVJ i qëndron argumentit se, mbështetur në Kodin e Punës, është punëdhënësi që kërkon dhe autorizon kryerjen e orëve shtesë dhe jo punëmarrësi. Për sa kohë nuk ka një referencë ligjore ku të mbështetet neni i rregullores, GVJ i qëndron mendimit se neni duhet ndryshuar e për rrjedhojë **observacioni nuk mund të pranohet.**

11. Observacioni nr. 11 – Referenca: Standardi V.2, Kriteri 5

Lidhur me linqet e paaksesueshme, GVJ thekson se këto linqe janë sjellë nga grupi i vlerësimit të brendshëm si evidenca dhe se për sa kohë sillen të tilla, duhet të jenë të depozituara dhe të aksesueshme në një formë apo tjetër në dosjen e vlerësimit elektronik, sikurse janë evidencat e tjera. Konkretisht, qoftë edhe në RVB, një mënyrë për të ruajtur formatin e dokumentit të tillë që të aksesohen linqet, do të ishte depozitimi me firma elektronike, që me pajisjet e sotme teknologjike është mjaft i thjeshtë. Po kështu, në e-ASCAL janë depozituar dy raporte të vlerësimit të brendshëm, njëri me firmat e GVB-së dhe tjetri pa firma. Në RVB-në pa firma, linqet mund të ishin të aksesueshme, mqs nuk ishte e nevojshme të skanohej materiali. Argumenti që ky shqetësim nuk u adresua përgjatë vizitës në terren nuk qëndron, sepse eksperti R. Muça u shpreh specifikisht në takimin me përfaqësuesen e zyrës së projekteve se “materialet e depozituara, përfshirë edhe RVB-në, nuk japin mundësi për hapjen e linqeve kur klikohet mbi to”. Në dokumentin që u depozitua pas vizitës në terren, linku i materialit të kësaj zyre është i aksesueshëm, rrjedhimisht mundësia ekziston. **Observacioni nuk pranohet.**

12. Observacioni 12 – Referenca: Standardi V.6, Kriteri 4

Vlerësimi që ka bërë GVJ për këtë kriter nuk i referohet indikatorëve, por faktit që mungojnë të dhënat që kjo zyrë duhet të publikojë ndër vite. Ka vetëm një të dhënë pa kohë dhe kaq. Mënyra e formulimit të observacionit është evazive dhe nuk adreson vlerësimin e bërë nga GVJ. **Observacioni konsiderohet pa lidhje me vlerësimin e kriterit.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Ekonomi Ndërmarrje”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PRORAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Ekonomi Ndërmarrje” në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” përfaqëson realizimin e një prej pikave të Marrëveshjes së vitit 1993 midis Kishës Katolike dhe Qeverisë Shqiptare ⁵ në lidhje me formimin e specialistëve për menaxhimin e institucioneve publike dhe private në Shqipëri.			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit në “Ekonomi Ndërmarrje” ⁶ synon formimin e specialistëve për menaxhimin e institucioneve publike dhe private në Shqipëri në përputhje me nevojat e vendit, por dhe perspektivën europiane të tij.			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Ekonomi Ndërmarrje” ofrohet në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” ⁷ . Programi është në përputhje me standardet europiane dhe me frymën e ngritjes së UKZKM për të ofruar një arsim cilësor universitar dhe pasuniversitar.			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi është hartuar përmes një bashkëpunimi intensiv me universitetet italiane. Prezenca e pedagogëve italianë ⁸ garanton të njëjtën cilësi mësimdhënie si në Itali, duke çuar kështu në njohjen e titujve të përbashkët dhe të dyfishitë për të gjitha programet dhe formimin e të diplomuarve për të qenë konkurrues në tregun shqiptar dhe europian.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			

⁵ Evidencë nr. 14: Marrëveshja ndërmjet Kishës Katolike dhe Qeverisë Shqiptare në vitin 1993.

⁶ Evidenca nr. 18 Rregullore e Programit të Studimit bachelor “Ekonomi Ndërmarrje”

⁷ Evidencë nr. 13, Statuti UKZKM, Neni 2.

⁸ Evidenca nr. 29 Docente UKZKM dhe universiteti partner

Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Hartimi dhe organizimi i programit të studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” është në përputhje me objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit ⁹ . Qëllimi i UKZKM ka qenë të ofrojë program të njëjtë me Universitetin e Barit dhe diplomë të përbashkët të të dy universiteteve ¹⁰ .			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Institucioni vepron në përputhje të plotë me Statutin ¹¹ , Rregulloren e Fakultetit ¹² dhe Rregulloren e Programit të Studimit ¹³ për mbarëvajtjen e procesit akademik. Programi i studimit në “Ekonomi Ndërmarrjeje” është në përputhje të plotë me nenet 2 dhe 3 të Statutit të Universitetit ¹⁴ .			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Në përputhje me Rregulloren e Fakultetit dhe Planin e Zhvillimit Institucional ¹⁵ , Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale planifikon të organizojë programe studimi për formimin e njohurive dhe aftësive në përputhje me nevojat e ekonomisë shqiptare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Programi i studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” ¹⁶ synon të ofrojë njohuri në ekonomi, organizim, ligj, vendim-marrje, etj për strukturat e organizatave publike dhe private. Gjithashtu, programi rëndësi i jep formimit të profesionistëve të pavarur dhe konsulentëve në fushat ekonomike. Programi balancon njohuritë në katër disiplina: menaxhim, ekonomi, kontabilitet dhe juridik.

⁹ Evidencw Nr 17 Plani i Studimit i programit bachelor “Ekonomi Ndërmarrjeje”

¹⁰ Evidencë nr. 5, Neni 1 i Marrëveshjes ndërmjet Universitetit të Barit “Aldo Moro” dhe UKZKM, dt 26.03.2019.

¹¹ Evidencë nr. 13, Statuti i UKZKM.

¹² Evidencë nr. 15, Rregullorja e Fakultetit.

¹³ Evidencë nr. 18, Rregullorja e Programit të Studimit.

¹⁴ Evidencë nr. 13, Statuti i UKZKM.

¹⁵ Evidencë nr. 16, Plani i Zhvillimit Institucional.

¹⁶ Evidencë nr. 17, Plani i Studimit për Programin Bachelor “Ekonomi Ndërmarrjeje”.

<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka një Plan të Zhvillimit Institucional 2017-2027¹⁷, por për Fakultetin e Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale duket që një pjesë e parashikimeve nuk janë mundësuar, edhe për shkak të situatës së vështirë të krijuar nga COVID 19, në këto kushte ndjehet nevoja e rishikimit të Planit dhe për më tepër planet 10 vjeçare janë shumë afatgjata në një dinamikë globale me të cilën po përballemi.</p> <p>Analiza e Tregut të Punës¹⁸ mbështetet në një analizë të programeve në ekonomik, financë dhe menaxhim të universiteteve shqiptare, duke evidentuar veçorinë e këtij programi.</p> <p>Gjithashtu, mbështetje është suksesi i këtij programi në Universitetin e Barit, si dhe raporti mbi punësimin e studentëve që përfundojnë këtë program, i cili mbetet gjithësesi shumë i përgjithshëm. <i>Analizën do e pasuronte paraqitja e regjistrimeve vit pas viti të studentëve në këtë program studimi, si dhe informacioni nga tregu i punës.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit bachelor “Ekonomi Ndërmarrje”¹⁹ është i njëjtë me programin që zhvillohet në Universitetin “Aldo Moro” të Barit, i akredituar dhe nga Ministria e Arsimit, Universiteteve dhe Shkencës në Itali²⁰.</p> <p>Programi ofrohet në përputhje me Procesin e Bolonjës dhe është organizuar në module dhe kredite bazuar në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Modulet/lëndët zhvillohen në gjuhën italiane dhe diploma lëshohet e përbashkët nga UKZKM dhe Universiteti i Barit²¹, gjë që hap perspektivë për studentët e diplomuar dhe në tregun evropian.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale është një nga njësitë kryesore të UKZKM. Që nga viti 2015, UKZKM, përmes Vendimit të Senatit Akademik dt. 24.01.2015²², ka miratuar strukturën me dy departamente dhe një qendër kërkimore, përkatësisht: Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Sipërmarrjeve;</p>

¹⁷ Evidencë nr. 16, Plani i Zhvillimit Institucional.


¹⁸ Evidencë nr. 91, Analiza e tregut të punës – BA “Ekonomi Ndërmarrje”.

¹⁹ Evidencë nr. 17, Plani i Studimit për Programin Bachelor “Ekonomi Ndërmarrje”.

²⁰ Evidencë nr. 6, Dekreti nr. Prot. 381, dt. 13.06.2014 i Akreditimit të Programeve të Studimit dhe seli 2014-2015.

²¹ Evidencë nr. 53, Modeli i Pergamenës.

²² Evidencë nr. 23, Shkresa përcjellëse nr. 131, dt. 26.01.2015 “Komunikimi i vendimit të Senatit Akademik në lidhje me strukturën e Fakultetit”.



	<p>Departamenti i Strategjive Bioekonomike në BE dhe Ballkan dhe Qendra e Studimeve mbi Ekonominë e Vendeve në Tranzicion.</p> <p>Referuar të dhënave tabelore, tabelës nr. 1 Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 31 pedagogë, nga të cilët 24 janë pedagogë efektiv (PAE), (13 shqiptarë dhe 11 italianë), nga ku: 2 kanë titullin “Profesorë”, 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD, dhe 7 Asistent Lektorë me Msc; dhe 7 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar”, 3 kanë gradën Dr./PhD. dhe 3 Asistent Lektorë me Msc.</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit bachelor në “Ekonomi ndërmarrjeje” është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të Departamentit nga buron dhe të fakultetit përkatës, si dhe në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe evropiane. Dekani i Fakultetit drejton dhe koordinon veprimtarinë mësimore, shkencore për programet e cikleve BA dhe master, duke iu përmbajtur udhëzimeve kombëtare, evropiane, por duke respektuar marrëveshjen me Universitetin “Aldo Moro” të Barit²³.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, sipas klasifikimit të programeve të studimit dhe sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.


²³ Evidencë nr. 5, “Marrëveshja midis UKZKM dhe Universitetit të Barit “Aldo Moro”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti, në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi përmes ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësisë, sinergjisë së krijuar mes njërive dhe analizës së vazhdueshme²⁴.</p> <p>Në institucion, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan koordinatori i fakultetit, i cili koordinon dhe vë në eficiencë administrimin e programit. Koordinatori i programit përpilon një raport periodik në lidhje me veprimtarinë e Fakultetit dhe aspektet koordinuese department, studentë dhe zyra e njësi të administrimit.</p>			
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për të realizuar objektivat e procesit mësimor e të formimit të studentëve, institucioni ka një marrëveshje bashkëpunimi shumë të rëndësishme me Universitetin e Barit "Aldo Moro"²⁵, marrëveshje e cila përbën dhe bazën e zhvillimit të gjithë veprimtarisë së universitetit dhe që krijon diferencimin në tregun e arsimit të lartë në Shqipëri. Në lidhje me marrëveshjet me aktorët e biznesit, marrëveshja më e rëndësishme është me Confindustrian²⁶, e cila është përfaqësuese dhe e biznesit italian në Shqipëri.</p>			
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njëria përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në lidhje me raportet e përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit me industrinë dhe tregun e punës, personi përgjegjës i Zyrës së Karrierës, u shpreh për një raport të tillë, <i>por ky raport nuk iu vendos në dispozicion GVJ.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Praktika mësimore e programit bachelor "Ekonomi Ndërmarrje", realizohet bazuar në përzgjedhjen e studentit të organizatës /kompanisë ku do të zhvillojë praktikën dhe më pas në sjelljen e një dokumenti që konfirmon periudhën e angazhimit.</p> <p><i>Mbetet e paqartë mënyra e vlerësimit të studentëve në praktikë, dhe mënyra e organizimit të praktikës.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Departamenti dhe njësitë e tjera të Fakultetit dhe Universitetit bëjnë përpjekje për mbështetjen e mëtejshme të studentëve, por nuk ekziston një plan aktivitetesh i formalizuar në këtë drejtim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

²⁴ Evidencë nr. 15, Rregullore e Fakultetit.

²⁵ Evidencë nr. 5, "Marrëveshja midis UKZKM dhe Universitetit të Barit "Aldo Moro".

²⁶ Evidencë nr. 25 <https://www.unizkm.al/search?q=impres+italiane>



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” hapur me Vendimin nr. 567, dt 28/08/2004, si një program i përbashkët studimi ²⁷ ndërmjet UKZKM dhe Universitetit të Barit “Aldo Moro” është në përputhje të ligjit dhe të akteve nënligjore në fuqi. Kurrikula ²⁸ është hartuar në module dhe kredite në përputhje me Sistemin Evropian për Grumbullimin dhe Transferimin e Krediteve (ECTS), legjislacionin italian dhe shqiptar, Në një semester studentët marrin rreth 30 kredite dhe në një vit rreth 60.
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” synon të ofrojë njohuri në lidhje me aspektet ekonomike, organizative, ligjore, të vendim-marrjes, si dhe përdorimin e metodave sasiore për menaxhimin e ndërmarrjes ²⁹ . Gjithashtu lëndët dhe modulet japin mundësinë e formimit të ekonomistëve që shërbejnë në sektorin publik dhe të atyre që do projektojnë karrierën profesionale në konsulencë biznesi dhe ligjore ³⁰ .
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Të diplomuarit në bachelor “Ekonomi Ndërmarrjeje” mund të punojnë në kontabilitet, marketing, menaxhim prodhimi, operator në sistemin bankar, si dhe mund të akomodohen në sektorin publik, organizata joqeveritare, si dhe mund të nisin karrierën në lëmin e konsulencës. Mundësinë për një përshtatje kaq të gjerë me tregun e punës vendas e më gjerë e jep kuadri teorik dhe praktik i lëndëve që zhvillojnë.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve	Programi i studimit bachelor “Ekonomi Ndërmarrjeje”, bazuar në Rregulloren e Programit, përmes lëndëve dhe moduleve të realizuara, jep mundësinë e fitimit të njohurive, aftësive, por dhe të qëndrimeve, për përballimin dhe zgjidhjen e problemeve komplekse në ndërmarrjet qoftë publike, qoftë private. Në kurrikul evidentohet fakti që lëndët të cilat kanë një rëndësi të veçantë për analizën, të menduarit

²⁷ Evidenca nr. 5, Marrëveshja UKZKM dhe Universiteti i Barit “Aldo Moro”.

²⁸ Evidenca nr. 17, Plani i studimit i programit të studimit “Ekonomi Ndërmarrje”.

²⁹ Evidenca nr 18, Rregullore e Programit të Studimit “Ekonomi Ndërmarrje”.

³⁰ Evidenca nr. 20, Dekreti i këshillit të departamentit të universitetit partner.

komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	kritik dhe përdorimin e teknikave sasiore dhe modeleve për zgjidhje, zenë një peshë të rëndësishme në numrin e krediteve dhe të orëve të vëna në dispozicion.			
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” është hartuar në përputhje të plotë me aktet ligjore e nënligjore dhe në përputhje me Statutin e Universitetit ³¹			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit, bazuar në Rregulloren e Programit ³² dhe në Planin e Studimit ka 23 lëndë, me 3 deri në 10 kredite, praktikën profesionale me 2 kredite dhe temën e diplomës me 3 kredite ³³ . Lëndët bazë të kategorisë A përmbajnë 10% të totalit të krediteve. Lëndët karakterizuese të kategorisë B përmbajnë 30% të totalit të krediteve. Lëndët ndërdisiplinore/plotësuese të kategorisë C përmbajnë 30% të totalit të krediteve, Lëndët plotësuese – Kategoria D përmbajnë 10 % të krediteve dhe detyrimet përmblyëse përmbajnë 20% të krediteve. Praktikën studentët e zhvillojnë në kompani/institucione që i përzgjedhin vetë, por mund të angazhohen dhe në kompanitë /institucionet pjesë e marrëveshjes së UKZKM.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	GVJ referuar informacionit në systemin e informacionit të ASCAL, konstaton se Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë është akredituar për herë të parë si institucion sipas Urdhrit Nr. 136, datë 25.03.2016, të MAS dhe ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 112, datë 15.12.2017, të Bordit të Akreditimit 6 vite akademike me afat vlefshmërie deri më datë 14.12.2023. Programi i studimit Bsc në “Ekonomi Ndërmarrjeje është akredituar me Urdhër Nr. 340.16.09.2015. Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2004-2005. Në vitin 2015, Fakulteti strukturohet në dy

³¹ Evidenca nr. 13, Statuti UKZKM.

³² Evidenca nr 18 Rregullore e Programit të Studimit “Ekonomi Ndërmarrjeje”

³³ Evidencë nr, 17, Plani i studimit i Programit të Studimit Ba në ‘Ekonomi Ndërmarrjeje’.

	<p>Departamente dhe në një qendër Kërkimore³⁴, në përputhje me nenin 23, paragrafi 2, të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Këto tre njësi, në përputhje me nenin 25 të Ligjit 80/2015, përbëhen nga të paktën 7 anëtarë, me kohë të plotë si personal akademik. Stafi akademik italian konfirmohet nga Universiteti partner i Barit “Aldo Moro”. UKZKM bashkëpunon me Universitetin partner për realizimin e programit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrje”. Mësimi kryhet nga pedagogë italianë dhe shqiptarë³⁵. Pedagogët italianë³⁶ mbulojnë në program të njëjtët lëndë që zhvillojnë dhe në Universitetin partner.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Drejtuesit akademikë, përkatësisht Koordinatori³⁷ i programit në “Ekonomi Ndërmarrjeje” ndërvepron me studentët dhe drejtuesin profesional të praktikës mësimore për mbarëvajtjen e studentëve në praktikë.</p> <p>Në fakt, gjatë vizitës në institucion rezultoi që studentët e zgjedhin vetë organizatën/institucionin ku do të realizojnë praktikën dhe mbeti përgjithësisht e paqartë mënyra si i ndjekin dhe vlerësojnë për punën e bërë.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i cili është përgjegjës për programin e studimit përmbush përgjithësisht detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale ka në përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Sipërmarrjeve; 2. Departamenti i Strategjive Bioekonomike në Bashkimin Evropian dhe në Ballkan; 3. Qendra e studimeve të Ekonomive të Vendeve në Tranzicion; <p>Mbetet për t’i kushtuar më shumë kujdes ngarkesës mësimore, javore për studentet, e cila mund të jetë sistemuar në dy vitet e fundit për shkak të mësimi <i>online</i>.</p> <p><i>GVJ rekomandon që Universiteti të punojë më shumë në këtë drejtim për të sistemuar një ngarkesë javore relativisht konstante dhe të mire-planifikuar. Gjatë vizitës kërkua një orar të semestrit, të cilën nuk e morëm dhe nuk u vendos në sistemin e-ASCAL në dokumentat shtesë që u kërkuan gjatë vizitës.</i></p>

³⁴ Evidencë nr. 23, Shkresë Përcjellëse nr. 131, dt 26.01.2015 “Komunikimi i Vendimit të Senatit Akademik në lidhje me Strukturën e Fakultetit”.

³⁵ Evidenca nr. 24, Trupa e pedagogëve UKZKM.

³⁶ Evidencë nr. 29, Pedagogë të UKZKM dhe universitetit partner.

³⁷ Evidenca nr. 35, Përshkrimi i punës së koordinatorit.

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Fakulteti përmbush detyrimet ligjore në lidhje me numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej **31 pedagogë**, nga të cilët **24 janë pedagogë efektiv (PAE)**, (13 shqiptarë dhe 11 italianë), nga ku: 2 kanë titullin “Profesorë”, 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD, dhe 7 Asistent Lektorë me Msc; dhe **7 pedagogë me kontratë (PAK)** nga ku 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar”, 3 kanë gradën Dr./PhD. dhe 3 Asistent Lektorë me Msc. Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021:

Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Sipërmarrjeve;

- 9 PAE, ndër të cilët 5 me tituj / grada;
- 3 PAK, ndër të cilët, 3 me tituj / grada;

Departamenti i Strategjive Bioekonomike në Bashkimin Evropian dhe në Ballkan;

- 8 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada;
- 1 PAK, me tituj / grada;

Qendra e studimeve të Ekonomive të Vendeve në Tranzicion;

- 7 PAE, ndër të cilët 6 me tituj / grada;
- 3 PAK, ndër të cilët, 0 me tituj / grada;

Përsa më sipër GVJ konstaton se Njësia kryesore përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për për nivelin e kualifikimit të personelit akademik.

Fakulteti³⁸ ka në strukturën e tij figurën e Koordinatorit³⁹, i cili kujdeset për studentët e dy programeve: “Ekonomi Ndërmarrjeje” dhe “Ekonomi e Menaxhim”. Koordinatori ka për detyrë të kujdeset për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive mësimore, përmbushjen e detyrimeve ligjore të procesit akademik dhe ka komunikim të vazhdueshëm me pedagogët dhe studentët. Koordinatori dokumenton të gjithë procesin e të nxënësve dhe informon drejtpërdrejt Dekanin.

Fakulteti/departamenti përcaktojnë saktë rolin e pedagogëve në aktivitetet kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare, ndërvepron me koordinatorin e fakultetit dhe zyrat suportuese të studentëve: Zyrën e Karrierës, Nuklin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³⁸ Evidenca nr. 15, Rregullore e Fakultetit.

³⁹ Evidenca nr. 35, Përshkrimi i punës së koordinatorit.

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Referuar RVB-së Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale, përgjegjës për programin e studimit bachelor “Ekonomi Ndërmarrje”, është ai që planifikon, koordinon, zhvillon, organizon dhe kontrollon procesin akademik dhe kërkimin shkencor dhe që ka informacion të plotë për të gjitha veprimtaritë në përputhje me kurrikulën e programit të studimit.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Referuar planit mësimor programi i studimit në “Ekonomi ndërmarrje” ka një kohëzgjatje 3 vite akademike, 180 ECTS, të cilat shpërndahen në 23 lëndë/disiplina mësimore, praktikë dhe Punim Diplome ⁴⁰ . Sistemi i vlerësimit të studentëve është sipas sistemit italian nga 18-30.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit tregon mënyrën e organizimit në lëndë/module me kreditet përkatëse dhe vitet ku zhvillohen. Programi i studimit është i njëjtë si në formë, ashtu dhe në përmbajtje me atë të ofruar nga Universiteti i Barit, si dhe i akredituar nga Ministria e Arsimit, Universtitetit dhe Kërkimit Shkencor në Itali.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuencimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Plani mësimor ⁴¹ i këtij programi nuk përmban të gjitha treguesit e disiplinës së referencës, kreditet përkatëse, ndarjen në vite (mbeti e paqartë gjatë vizitës në institucion se si ndahen veprimtaritë në klasë dhe jashtë saj, si dhe orët përkatëse). Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, por dhe gjatë verifikimit të përmbajtjes së syllabuseve ⁴² u evidentua që mënyra e vlerësimit nuk ishte e paraqitur me të gjitha elementët që paraqitet në RVB, në pjesën më të madhe të syllabuseve. Përvoja e Universitetit partner në këtë drejtim mund të sjellë një format që është në lirinë akademike të pedagogëve.
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion studentët, para regjistrimit, informohen nga Sekretaria Mësimore dhe Koordinatori i Programit, nga Dekani dhe stafi akademik lidhur me programin e studimit, gjendjen e tij, akreditimin në Shqipëri dhe Itali, organizimin e studimeve, kohëzgjatjen dhe vlefshmërinë në nivel evropian.
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet	Syllabuset e lëndëve, në pjesën më të madhe të tyre, janë në formatin e shkurtuar, që nënkupton që syllabusi nuk detajon brenda secilës temë,

⁴⁰ Evidenca nr. 17, Plani i studimit i Programit Bsc “Ekonomi Ndërmarrje”.

⁴¹ Evidenca nr. 17, Plani i studimit i Programit Bsc “Ekonomi Ndërmarrje”.

⁴² Evidenca nr. 21, Syllabuset e Programit të Studimit.

<p>lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>çështjet të cilat do trajtohen, shembujt, rastet studimore, ushtrimet në seminarat dhe orët praktike.</p> <p>Evidentuar dhe problematika në paraqitjen e literaturës së përdorur, si dhe në literaturën e përdorur, ku nevojitet për një pjesë të lëndëve që krahas literaturës italiane të kemi dhe literaturë shqiptare.</p> <p>Formatit të syllabusit, në pjesën më të madhe të tyre, i mungon dhe mënyra e vlerësimit dhe komponentët e vlerësimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon përmirësimin e formatit të syllabuseve, në përputhje me standartin shqiptar, përshkrimi i përmbajtjes së çdo teme, i seminareve dhe metodës së përdorur për secilin prej tyre, mënyrës së vlerësimit dhe literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduara, detyra në Ëeb, si dhe mënyrën e vlerësimit. Vëmendje duhet t'i kushtohet që literatura të jetë e pesë viteve të fundit.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në lidhje me ndryshimin e përmbajtjes së programeve të studimit, kjo ndodh gjithnjë në marrëveshje me Univeristetin e Barit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar planit mësimor GVJ konstaton se, PS Bsc në Ekonomi Ndërmarrjeje, përmban</p> <ul style="list-style-type: none"> - 180 Kredite, -Viti i parë 520 orë në auditor /1180 orë jashtë auditorit; -Viti i dytë 428 orë në auditor /1047 orë jashtë auditorit; -Viti i tretë, 445 orë në auditor /1005 orë jashtë auditorit; <p>GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Referuar Planit Mësimor, sipas Tabelës 10 të (dokumentit 27 fq 23, 24 dhe 25) Programi i Studimit Bachelor në "Ekonomi Ndërmarrjeje"</p>

	<p>përmban 180 kredite dhe 4700 orë ngarkesë mësimore të ndarë në 3 vite.</p> <p>Parashikimet ligjore janë 4500 orë mësimore dhe në këto kushte <i>GVJ rekomandon që institucioni të rishikojë ngarkesën mësimore në total dhe të balancojë ngarkesën mësimore në vitet e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programi bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje”, përmes lëndëve dhe moduleve, leksioneve, seminareve dhe praktikave mundëson formimin e studentëve në përputhje me objektivat e programit, por dhe nevojat e tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit jep njohuri dhe krijon aftësi të rëndësishme për të sapo-diplomuarit, duke u krijuar atyre mundësi të integrohen në sektorë të ndryshëm brenda ndërmarrjes publike dhe private.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, por dhe shqyrtimit të dokumentacionit, planit mësimor⁴³ të paraqitur, mbeti e paqartë mënyra e ndarjes së orëve mësimore dhe si vlerësohen kreditet me orët mësimore, përpos raportit 1 ECTS = 25 orë, që është ligjore.</p> <p>Në syllabuset⁴⁴ e një pjese të lëndëve/moduleve nuk qartësohet si ndahen leksionet dhe seminarat dhe cili është sistemi i vlerësimit të studentëve në seminare/provim i ndërmjetëm/detyra kursi/provim përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre janë në përputhje me programin e studimit të Universitetit të Barit, kjo buron nga marrëveshja e diplomës së përbashkët mes dy universiteteve⁴⁵ dhe nga ligjet dhe akte të tjera nënligjore.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit është i njëjtë, në masën 80%, me atë të Universitetit të Barit, sepse është kërkuar të merren parasysh dhe specifika të kontekstit shqiptar në formim.</p> <p>Kombinimi i aspekteve teorike dhe praktike në një kurrikul italiane u ofron studentëve mundësinë që të kenë avantazh në tregun e punës shqiptar, italian dhe më gjerë. Studentët kanë të drejtë për lëvizje/transferim studimesh brenda dhe jashtë vendit me programin <i>Erasmus +</i>.</p> <p><i>Ndarja e veprimtarive formuese mbetet e paqartë në një numër lëndësh.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke</p>	<p>Syllabuset përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, përdoret kryesisht literaturë italiane, por ka vend për t’u përmirësuar paraqitja e literaturës në syllabuse dhe përditësimi i saj në 5 vitet e fundit.</p>

⁴³ Evidenca nr. 17, Plani mësimor i programit “Ekonomi Ndërmarrje”.

⁴⁴ Evidenca nr. 21, Syllabuset.

⁴⁵ Evidenca nr. 5, Marrëveshje mes UKZKM dhe Universitetit të Barit “Aldo Moro”.

u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Duhet theksuar që një pjesë e rëndësishme e lëndëve/moduleve mbulohen nga pedagogë me shumë përvojë të Universitetit të Barit dhe të universiteteve të tjera italiane ⁴⁶ .			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Përmbajtja e programeve është e tillë që krijon mundësinë e formimit profesional në ekonomi, menaxhim, administrim publik, por hap dhe perspektiva për të punuar studentët në profesione të lira.			
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ekonomi, menaxhim, financë dhe marketing në universitete shqiptare, italiane dhe ndërkombëtare. Përmbajtja e programit bachelor “Ekonomi Ndërmarrjeje” dhe titulli i diplomës i përbashkët UKZKM dhe Universiteti i Barit ⁴⁷ , natyrisht rrit preferencën e studentëve në tregun e punës vendas, por i jep mundësi dhe në tregun evropian.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Pedagogët me përvojë të Universitetit të Barit, në bashkëpunim me pedagogët shqiptarë, përpiqen të përditësojnë njohuritë dhe të krijojnë aftësi në përputhje me dinamikën e tregut të punës, i cili bëhet më global.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Evidenca	Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, i angazhuar në realizimin e programit të studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje”, plotëson kërkesat e parashikuara nga ligji në fuqi. Nga pikëpamja e ndërveprimit me studentët, mënyra si organizohet realizimi i ngarkesës mësimore të lëndëve/moduleve mund të ketë disa problematika, megjithatë sot është e mundur të komunikosh e t’u shërbesh nevojave/kërkesave të studentëve përmes platformave të ndryshme dhe e-mail.

⁴⁶ Evidenca nr. 22/1, 22/2, CV e stafit akademik.

⁴⁷ Evidenca nr. 53, Pergamena.

	<p>Të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie⁴⁸ për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë: Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 31 pedagogë ndër të cilët 24 PAE dhe 7 PAK.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 77% PAE dhe 23% PAK.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 30 pedagogë ndër të cilët 22 PAE dhe 8 PAK.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 74% PAE dhe 26% PAK.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 janë të angazhuar 30 pedagogë ndër të cilët 21 PAE dhe 9 PAK.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 70% PAE dhe 30% PAK.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i Universitetit të Barit, i angazhuar me kohë të plotë në këtë program studimi, certifikohet çdo vit nga Dekani i Fakultetit, në bashkëpunim me Rektorin dhe Universitetin partner. Personeli akademik që vjen nga universiteti partner dhe ai shqiptar⁴⁹, kanë kualifikimet e duhura për realizimin e programit të studimit bachelor “Ekonomi Ndërmarrje”.</p> <p>Për sa i përket kualifikimeve të Personelit Akademik për tre vite:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për 2018-2019, 83% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 17% janë Msc; - Për 2019-2020, 73% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 27% janë Msc; - Për 2020-2021, 70% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 30% janë Msc.
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për këtë vit akademik përbëhet nga: 2 profesorë – 6% e stafit akademik; 7 profesorë të asocjuar – 26% e stafit akademik; 11 PhD – 36% e stafit akademik; 1 PhD kandidat – 3% e stafit akademik dhe 9 asistentë me titull “Master i Shkencave”.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion na rezultoi që praktika mësimore përgjithësisht organizohet përmes dakordësisë së studentëve me koordinatoren e programit për përzgjedhjen e organizatës/kompanisë ku do të zhvillojnë praktikën.</p> <p>Zyra e Karrierës vë në dispozicion të studentëve gjithashtu mundësi intershipi/punësimi nga organizata, me të cilat UKZKM ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>

⁴⁸ Evidenca Tabela Përmbledhëse pdf Nr 2, 6.1, 6.2

⁴⁹ Evidenca nr. 29, Pedagogët e UKZKM dhe universitetit partner.

udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në përputhje me nevojat e programit të studimit, institucioni angazhon personel ndihmës. Në kuadrin e programit të studimit “Ekonomi Ndërmarrje” në shërbim të studentëve dhe pedagogëve është laboratorit IT dhe ambiente të tjera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	UKZKM synon arritjen e standardeve akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, gjë që evidentohet dhe në dokumentat e tij të brendshme, siç është Statuti ⁵⁰ dhe Plani i Zhvillimit Strategjik ⁵¹ . Prezenca e pedagogëve italianë impakton procesin dhe ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm. Gjatë vizitës në institucion, përmes intervistave, nuk evidentuam realizimin e trajnimeve me stafin akademik. <i>GVJ rekomandon hartimin e një plani vjetor të trajnimit të stafit akademik që mund të diferencohet nga titujt dhe gradat, të jetë dhe tematik.</i>

⁵⁰ Evidenca nr. 13, Statuti UKZKM.

⁵¹ Evidenca nr. 16 Plani i Zhvillimit Institucional.

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe takimeve në institucion Dekani i Fakultetit, i cili është personi përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor, i kërkon secilit Drejtor Departamenti një raport me këtë objekt përpara fillimit të vitit akademik. Më pas, Dekani përgatit një raport të hollësishëm për Rektorin dhe Senatën Akademik ku përshkruhet progresi në procesin mësimor, kërkim dhe raportet me industrinë; vend të veçantë zë vizioni për zhvillimin e fakultetit⁵².</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe vizitë në institucion GVJ konstatoi se vlerësimi i cilësisë në UKZKM kryhet përmes formave të ndryshme, forma kryesore është ajo e vlerësimit të studentëve për mësimdhënien dhe stafin akademik nëpërmjet pyetësorëve⁵³. Raporti i rezultateve të mbledhura i paraqitet Rektorit⁵⁴. <i>Një praktikë e tillë duhet bërë semestrale/vjetore dhe duhet pasuruar me forma të ndryshme si: takimet e departamentit me studentët apo fokus grupet e studentëve. Gjithashtu, duhen vlerësuar dhe shërbimet ndihmëse dhe administrative në institucion.</i> Koordinatori i programit ndërvepron gjatë gjithë vitit akademik me studentët, trajton me ta shqetësimet dhe problematikat dhe i përcjell në instancat administrative dhe akademike.</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia e Brendshme e Vlerësimit të Cilësisë⁵⁵, e krijuar në fillim të vitit akademik 2019-2020, edhe për shkak të situatës COVID-19, nuk kishte mundur të realizonte detyrat e saj dhe nuk kishte operuar me pyetësorët apo me forma të tjera të vlerësimit të cilësisë së procesit akademik. Duhet thënë që gjatë vizitës në institucion rezultoi që ishte formuluar vetëm një raport bazuar tek pyetësorët me studentët. <i>GVJ rekomandon që të zbatohet parimi i përmirësimit të vazhdueshëm në institucion. Raportet dhe e gjithë puna e Grupit të Brendshëm të Cilësisë duhet të jetë e vazhdueshme, me faza të proceseve të projektuara për çdo vit akademik, me përjasje analizuuese përmirësuese dhe zhvilluese.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Një mekanizëm i rëndësishëm është ndërveprimi i koordinorit të programit me studentët, duke organizuar takime periodike me ta. Nëse shihet e nevojshme, në këto takime merr pjesë Dekani apo Drejtori i Departamentit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

⁵² Evidenca nr. 31, Raporti vjetor i aktivitetit didaktik nga Dekani.

⁵³ Evidenca nr. 33, Formulari i pyetësorit.

⁵⁴ Evidenca nr. 34, Raporti i perceptimit të studentëve mbi veprimtarinë mësimore.

⁵⁵ Evidenca nr. 87, Përbërja e nuklit të vlerësimit të cilësisë.

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në UKZKM dhe më specifikisht në programin e studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje”, procesi mësimor zhvillohet me orë leksionesh në auditor, orë ushtrimesh dhe seminaresh, detyra praktike dhe kërkimore mbi temat e trajtuara gjatë leksioneve.</p> <p>Në traditën e universitetit organizohen dhe leksionet e hapura me të ftuar të huaj dhe shqiptarë, përfaqësues institucionesh të rëndësishëm, operatorë të rëndësishëm në treg dhe ekspertë të fushave specifike.</p> <p>Vlen të ritheksohet që në <i>syllabuset duhet qartësuar përmbajtja e çështjeve të leksionit, metodologjia e përdorur në seminare, detajuar literatura e përdorur me faqet respektive, linqet e siteve, të përcaktohen javët dhe temat në të cilat do të ketë të ftuar në auditor dhe format e vlerësimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Në frymën e UKZKM dhe më specifikisht personeli akademik i programit të studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta për mësim-nxënien e studentëve, pa diskriminim. Gjithashtu, në eksperiencën e këtij universiteti, studenti mbështetet me këshillim akademik dhe konsultime në prag provimesh apo kur i shfaqet nevoja. Një pjesë e rëndësishme e personelit akademik, përveç titujve dhe gradave shkencore, ka një sërë kualifikimesh kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ekspertizë profesionale të thelluar në fushën/displinën që ai/ajo mbulon.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni është i angazhuar për të realizuar një proces të mësimdhënies sa më cilësor, por gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me stafin nuk rezultoi të kishte trajnime periodike në drejtim të përmirësimit të kompetencave didaktike.</p> <p>Vitet 2020 dhe 2021, për shkak të situatës COVID-19 bën të domosdoshëm trajnimet të fokusuar në <i>digital skills</i>, kryesisht për përdorimin e platformave të mësimdhënies. UKZKM kishte zhvilluar një seri trajnimesh të tilla, të cilat në thelb kishin mundësuar kapërcimin me sukses të kësaj periudhe të jashtëzakonshme.</p> <p>Personeli akademik përdor në leksione dhe seminare metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke vënë në qendër herë pedagogun/herë studentin.</p>

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Një nga avantazhet e UKZKM është mësimdhënia përmes programeve dhe pedagogëve italianë, të cilët sjellin në mjedisin akademik përvojën dhe kompetencën e një prej universiteteve më të mira italiane dhe në këtë mënyrë zhvillojë dhe kolegët e bashkëpunëtorët e tyre në Shqipëri.			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Personeli akademik synon përdorimin e metodave inovative që u shërbejnë studentëve për përthithjen më të mirë të njohurive dhe aftësimin e tyre me shprehitë e duhura' Bashkëveprimi i studentëve të programit bachelor në "Ekonomi Ndërmarrjeje" me koordinatorin e tij bën të mundur që shqetësimet, preokupimet dhe këkesat e studentëve për më shumë angazhim të pedagogëve apo përmirësime të tjera të procesit akademik të reflektohen nga pedagogët.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Stafi akademik përdor metodat interaktive, vendos herë në qendër pedagogun dhe herë të tjera studentin, nxit të punuarin me literaturë të përditësuar, labororet e informatikës për programeve dhe platforma për t'i bërë sa më tërheqëse orët e mësimin.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Stafi akademik duke punuar me grupe relativisht të vogla studentësh nxit në mënyrë të vazhdueshme të menduarit kritik, punën në ekip, lidhshimin tek studentët, duke i përgatitur ata me aftësitë dhe qëndrimet që tregu lokal dhe evropian i punës kërkon.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga informacioni i depozituar në DVV, konstaton se UKZKM vë në dispozicion të procesit mësimor, studentëve dhe pedagogëve hapësira mjaft cilësore të cilat dëshmojnë për seriozitetin e investimit. Gjithçka nga pikëpamja e investimit në godina, laboratore, hapësira rekreative është në standardet e universiteteve më të mira perëndimore.
Kriteri 2. Mjediset e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me	Mjediset për realizimin e procesit mësimor janë funksionale dhe të pajisura me të gjithë logjistikën e domosdoshme për realizimin e

logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	procesit mësimor, në përputhje me standardet. Sallat e leksioneve dhe seminareve rezultojnë, të jenë të pajisura me pajisjet <i>hardware</i> dhe <i>software</i> , me pajisjet audio-vizive si dhe kanë mbulim me internet, duke mundësuar kushte optimale për procesin mësimor.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	<p>UKZKM përdor disa sisteme informatike të cilat, sidomos në dy vitet e fundit akademike, kanë dëshmuar rëndësinë e investimeve të bëra në kohë dhe në sistemet e menaxhimit të informacionit. Sistemet e përdorura janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ UniMS – <i>University Management System</i>, që shërben për digjitalizimin e të gjithë të dhënave të prodhuara gjatë procesit mësimor dhe punës administrative dhe sekretarisë mësimore; ✓ ERP – <i>Enterprise Resource Planning</i>, që menaxhon dhe koordinon të gjitha proceset në universitet; ✓ Portali i studentëve – lidh studentët nga pikëpamja e informacionit me universitetin (pedagogë, koordinator dhe sekretari); ✓ Portali i Pranimeve – u shërben studentëve të ardhshëm si pikë informacioni, regjistrimi për provimet pranuese, vizualizimi të pikëve dhe pozicioni në renditje. Fituesit mund të vijnë më tej me regjistrimin ose të tërhiqen; ✓ Portali I Bibliotekës – është <i>Open Public Access Catalogue</i>, paraqitje digjitale e <i>Fratel Paolo Ruatti</i>. ✓ <i>Real Time Classroom</i> – me këtë modul është i lidhur <i>TV signage</i>, në çdo godinë dhe në kohë reale japin gjendjen e klasave, pedagogëve, lëndës, kursit dhe klasës. ✓ <i>Studnets'Apps</i> – aplikacion në celular që ofron të gjitha shërbimet e portalit studentor. <p>Gjatë kohës së pandemisë u përdorën gjithashtu:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ <i>Google classroom</i>, i cili është integruar me Google Met dhe UniMS ✓ Provimi Online – platformë e zhvilluar për provimet <i>online</i>.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse që u vihet në dispozicion studentëve në gjuhën italiane, shqiptare dhe angleze, garanton marrjen e njohurive të nevojshme në përputhje me objektivat e programit të studimit.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të	Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion, biblioteka e UKZKM “Paolo Ruati”, përmes shërbimeve të saj, ofron për studentët një shërbim cilësor dhe në përmbushje të nevojave të tyre për literaturë

programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	të përditësuar. Pjesa më e madhe e librave të bibliotekës janë në gjuhën italiane dhe një pjesë e tyre janë dhuruar nga pedagogët që janë titullarë të disiplinave mësimore të programit “Ekonomi Ndërmarrje”.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Biblioteka garanton gjithashtu mbështetjen e duhur për kërkimin në Internet, përmes motorrit të kërkimit <i>Hinari</i> , pjesë e një projekti që universiteti është përfshirë prej vitesh. Portali i Bibliotekës siguron kërkimin në Internet të literaturës dhe ndërveprimin me bibliotekën përmes seksionit FAQ. Gjithashtu, biblioteka vë në dispozicion të përdoruesve bashkëpunimin / ndërveprimin me bibliotekat e tjera përmes OPAC-ve dhe CDD-ve të tyre.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Në dispozicion të studentëve është laboratori i informatikës me 48 laptopë, me akses të shpejtë në Internet, si dhe një sërë hapësirash të tjera me laptopë / PC në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në funksion të mësimdhënies siç evidentuam dhe më lart universiteti përdor: <ul style="list-style-type: none"> ✓ UniMS – <i>University Management System</i>, që shërben për digjitalizimin e të gjithë të dhënave të prodhuara gjatë procesit mësimor dhe punës administrative dhe sekretarisë mësimore; ✓ ERP – <i>Enterprise Resource Planning</i> që menaxhon dhe koordinon të gjitha proceset në universitet; ✓ Portali i studentëve – lidh studentët nga pikëpamja e informacionit me universitetin (pedagogë, koordinator dhe sekretari); ✓ Portali i Pranimeve – u shërben studentëve të ardhshëm si pikë informacioni, regjistrimi për provimet pranuese, vizualizimi të pikëve dhe pozicioni në renditje. Fituesit mund të vijnë më tej me regjistrimin ose të tërhiqen; ✓ <i>Studnets'Apps</i> – aplikacion në celular, që ofron të gjitha shërbimet e portalit studentor; ✓ <i>Google classroom</i>, i cili është integruar me <i>Google Meet</i> dhe <i>UniMS</i>; ✓ Provimi Online – platformë e zhvilluar për provimet online;
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Referuar RVB, takimeve me stafin dhe studentët e programit, ka disa forma alternative të komunikimit të brendshëm. Personeli akademik, administrativ dhe studentët përdorin platformat e cituara më lart, sepse mënyra e brendshme e funksionimit dhe organizimit të universitetit është bazuar në to.

Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Stafi akademik udhëzon studentët në zgjedhjen e temave të diplomës, e cila fillon në vitin e dytë dhe ndiqet nga një pedagog udhëheqës. Në dispozicion të studentëve vihet rregullorja e temës së diplomës e cila nënvizon hapat, kohën formularët që do të dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në nivel institucional, me urdhër të Rektorit është ngritur në vitin 2019 “Njësia e brendshme e vlerësimit të cilësisë” ⁵⁶ , është hartuar Rregullorja e Njësisë së Vlerësimit ⁵⁷ e cila do të duhej të kishte një datë të miratimit, si dhe nga pikëpamja e dokumentacionit të qartësohej kush e ka formuluar rregulloren. <i>GVJ rekomandon funksionalizimin e Njësisë së Brendshme të Vlerësimit të Cilësisë, hartimin e planeve vjetore të vlerësimit të cilësisë, bashkëveprimin me Fakultetet dhe Departamentet, sjpërndarjen e pyetësorit çdo semester⁵⁸, dhe përfaqshjen suportuese bazuar në raportin që mat perceptimin e studentëve mbi procesin mësimor⁵⁹ dhe në parimin e përmirësimit të vazhdueshëm.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamentet e fakultetit janë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” dhe, në bashkëpunim të plotë mes tyre, garantojnë procesin mësimor dhe përmes gjithë veprimtarive të tyre përpiqen për të rritur vetëdijen e stafit dhe të studentëve në këtë drejtim.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Referuar vizitës në institucion si dhe takimeve me përfaqësues të strukturave drejtuese, rezulton se ata synojnë të mbështesin dhe të nxisin përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Përvoja italiane e mësimdhënies së pedagogëve të Universitetit të Barit shërben si inkubator zhvillimi për pedagogët dhe pjesën tjetër të stafit.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen	Bazuar në RVB dhe në vizitën monitoruese në UKZKM, shfaqet një vëmendje në rritje në lidhje me mbështetjen ndaj stafit akademik.

⁵⁶ Evidenca nr. 87, Përbërja e Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë.

⁵⁷ Evidenca nr. 88, Rregullorja e Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë.

⁵⁸ Evidenca nr. 33, Formulari i pyetësorit.

⁵⁹ Evidenca nr. 34, Perceptimi i studentëve mbi veprimtaritë mësimore.

<p>në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Lista e veprimtarive shkencore dhe didaktike⁶⁰ dëshmon për një veprimtari të pasur dhe ndërveprim me aktorë të rëndësishëm në tregun shqiptar e ndërkombëtar. Në vitin 2019, UKZKM hapi thirrje për projektet kërkimore⁶¹, përmes një procesi aplikimi, konkurrimi dhe mbështetje financiare të projekteve me të mira.</p> <p><i>GVJ rekomandon përcaktimin e kriterëve të vlerësimit të projekteve dhe të financimit të tyre.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në lidhje me trajnimet didaktike të brendshme ka gjithnjë hapësirë për më shumë fokus dhe dedikim. Gjatë vizitës në institucion, por nisur dhe nga dokumentacioni i paraqitur në sistemin e-ASCAL, mungon një plan trajnimesh në nivel institucional, fakulteti apo departamenti. Të vetmet trajnime të kryera në dy vitet e fundit janë trajnimet për përdorimin e platformave të mësimdhënies <i>online</i> dhe të provimeve <i>online</i>, të cilat kanë qenë të shpeshta dhe për shkak të gjendjes së emergjencës me të cilën u përballën universitetet dhe gjithë sistemi i edukimit në nivel global.</p> <p><i>GVJ rekomandon një plan vjetor trajnimesh i cili mund të burojë nga analiza e raporteve të vlerësimit të cilësisë, nga vlerësimi vjetor i pedagoëve dhe nga nevoja të tjera të institucionit apo stafit akademik</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Në mbështetje të Rregullores për Shpërndarjen e Kontributeve⁶² të UKZKM në Kërkimin Shkencor, çdo department përcakton linjat e kërkimit me prioritet. Mbi bazën e tyre pedagogët, individualisht ose në grupe, aplikojnë me projekte⁶³. Projektet vlerësohen nga një komision i ngritur nga Rektori dhe projektet fituese⁶⁴ mbështeten financiarisht. Nga pikëpamja procedurale duket që përjasja e zgjedhur është shumë pozitive, por pandemia dhe pezullimi i punës në disa aspekte të prezencës njerëzore ka bërë që fazat e projekteve të fituara të mos jenë çuar deri në fund.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me stafin akademik, rezultoi se personeli akademik dhe mbështetës raporton në mënyrë vjetore për rezultatet e punës së tyre në mësimdhënie, zhvillim profesional dhe kërkim shkencor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

⁶⁰ Evidenca nr. 36, Lista e veprimtarive shkencore dhe didaktike në seminare dhe konferenca.

⁶¹ Evidenca nr. 37, Buxheti për financimin e projekteve të Fakultetit Ekonomik.

⁶² Evidenca nr. 44, Rregulore për Shpërndarjen e Kontributeve universitare.

⁶³ Evidenca nr. 45, Modeli I kërkeses për kontribute për projekte.

⁶⁴ Evidenca nr. 46, Lista e projekteve të miratuara.

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimiit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimiit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në Rregulloren e Programit të studimit bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje” ⁶⁵ vlerësojmë që ka hapësirë për përmirësim në përmbajtjen e saj dhe në rubrikat e përdorura. Në Rregulloren e Fakultetit ⁶⁶ , <u>GVJ rekomandon që duhet qartësuar mënyra e vlerësimit në funksion të tipologjive të lëndëve (teorike dhe me karakter me aplikativ), gjithashtu GVJ krahas përmirësimit të syllabuseve nga pikëpamja përmbajtësore në trajtimin e çdo teme, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mënyrës së vlerësimit në provime, seminare dhe detyra.</u>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimiit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se mënyra e testimiit është me shkrim/me gojë dhe më të dyja format dhe u bëhet e ditur studentëve që në nisje të lëndës. Sistemi i vlerësimit i zbatuar është ai italian 18-30, i cili ekuivalentohehet përmes dispozitave ligjore me sistemin shqiptar dhe sistemet e tjera. Gjatë vizitës në institucion evidentuam që pranohet që sistemi i vlerësimit është ai i kontrollit të vazhdueshëm, <u>por GVJ rekomandon që kjo të specifikohet dhe në syllabuset dhe rregulloren e programit.</u>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Ndonëse në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm ⁶⁷ të programit të studimit flitet për disa forma të vlerësimit të studentëve, këtë e gjetëm gjatë vizitës në institucion dhe takimit me pedagogët më shpesh në formatin e vlerësimit me shkrim/me gojë dhe më pak të gërshetuar me detyrë në klasë dhe projekte. Liria akademike e pedagogëve dhe specifikat e lëndëve natyrisht duhen marrë në konsideratë dhe në format e vlerësimit, por këto duhen të qartësohen për çdo grup lëndësh/lëndësh. Si dhe më lart, <u>GVJ rekomandon specifikimin që në silabuset të shprehen qartë format e vlerësimit dhe vlerësimi për çdo formë.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

⁶⁵ Evidenca Nr.18 Rregullore e Programit të Studimit “Ekonomi Ndërmarrje”

⁶⁶ Evidenca Nr 15 Rregullore e Fakultetit

⁶⁷ Evidenca Nr 1 Raporti I Vlerësimit të Brendshëm

<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit/vitit akademik.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të syllabuseve të vëna në dispozicion, por dhe gjatë vizitës në institucion, evidentuam që në kuadrin e autonomisë akademike, pedagogët përdorin disa forma vlerësimi. Në fillimin e lëndës pedagogu qartëson mënyrën e vlerësimit me detyra / shlyerje / provim me shkrim / provim me gojë dhe i kombinuar.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në Syllabuse të standardizohet mënyra e vlerësimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni për vlerësimin e studentëve përdor referuar Neni 15 të Rregullores së Fakultetit provimin me shkrim dhe me gojë⁶⁸.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, pedagogët u shprehën që në periudhën e pandemisë kanë përdorur platformën “Google Meet”, në lëndë të tilla si: kontabiliteti, statistika është përdorur platforma online “exam.net”.</p> <p>Referuar vizitës me pedagogët, evidentohet që forma më e rëndësishme e vlerësimit është ajo e provimit me gojë.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar Rregullores së Fakultetit⁶⁹, Neni 15, pika 5 për zhvillimin e provimeve, testimi e vlerësimi i njohurive bëhet nga komisioni me dy pedagogë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës.</p> <p>Në Rregulloren e Provimeve⁷⁰ e cila përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - modalitete dhe procedura - dokumentacionin dhe plotësimin - rregulla të zhvillimit të provimit <p>Në pikën I.3, qartësohet komisioni i provimit i përbërë nga dy pedagogë, dhe gjithë procedura e monitorimit, vlerësimit dhe dorëzimit të dokumentacionit që duhet të realizohet prej tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Provimeve, Pika I.4 provimi mund të zhvillohet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - me shkrim - me gojë - me shkrim dhe me gojë <p>Tezat sekretohen nga Sekretaria Mësimore, që bashkëngjijt një zarf me një fletë brenda tij. Fleta plotësohet me të dhënat e studentit dhe mbyllet e sekretohet nga vetë studentit. Kopjet e testeve u shpërndahen studentëve nga komisioni i provimit. Korrigjimi i provimit bëhet me zarf të mbyllur dhe hapja e tij bëhet në prani të komisionit dhe studentëve.</p> <p>Në dy vitet e fundit, provimet janë kryer <i>online</i> dhe për këtë është hartuar një Rregullore <i>ad hoc</i>.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Provimit, Pika I.5 vlerësimi i njohurive dhe shprehive të fituara bëhet bazuar në sistemin italian:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi kalues minimal është 18 nga 30 pikë të mundshme;

⁶⁸ Evidenca Nr 15 Rregullore e Fakultetit

⁶⁹ Evidenca Nr 15 Rregullore e Fakultetit

⁷⁰ Evidenca Nr 48 Rregullore e Provimeve

është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	- vlerësimi maksimal është 30 pikë nga 30 pikë të mundshme; - vlerësimi Lode jepet për 30 pikë, nga i gjithë komisioni. Rregullorja qartëson gjithë dokumentacionin për provimin me shkrim, provimin me gojë dhe provimin me shkrim e me gojë			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Gjatë zhvillimit të provimit, institucioni merr disa masa për të shmangur kopjimin. Dhe në kushtet e provimeve <i>online</i> janë marrë disa masa për të shmangur kopjet. Referuar RVB-së gjatë provimit ka masa për të rritur sigurinë si: çaktivizimi i internetit në klasë gjatë kohës së provimit; provimi zhvillohet në Terminal Server Esami RDP në distancë, me përdorues specifikë dhe të shpërndarë në kohën e provimit; provimi shpërndahet dhe mblihet përmes softëare-t kompjuterik të zhvilluar në exel nga pedagogu përgjegjës i lëndës.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rregullorja e provimeve ka përcaktuar dhënien e rezultateve të provimit. Serioziteti i kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale është pjesë e integritetit profesional, por dhe pjesë e rëndësishme e sigurimit të një procesi cilësor akademik.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Bazuar në pikën I.6 të Rregullores së Provimit ⁷¹ , studenti ka të drejtë të ankohet kur: - ndaj tij janë shkelur rregullat e provimit - nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Studentët mund të kontaktojnë drejtpërdrejt koordinatoren ose pedagogun përkatës për të vendosur një datë takimi.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Bazuar në Rregulloren e Provimit, në rast të ankesës së studentit për vlerësimin, komisioni është i detyruar të ballafaqojë provimin e studentit me tezën e zgjidhur. Në rast mosdakordësie, studenti mund të ankohet me shkrim tek Dekani, brenda 72 orëve nga marrja e rezultatit, i cili merr vendimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

⁷¹ Evidenca Nr 48 Rregullore e Provimeve

<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Ekonomi ndërmarrjeje”⁷² synon t’i ofrojë studentëve njohuri dhe aftësi që i shërbejnë realitetit të ndërmarrjeve si publike, ashtu dhe private në aspektet ekonomike, menaxheriale, ligjore dhe sasiore. Në Rregulloren e Programit të Studimit⁷³ përcaktohet qartë synimi i ofertës formuese akademike për të krijuar një profil specialisti të ekonomisë që gjen veten në sektorë të ndryshëm të ndërmarrjes.</p> <p>Duhet patur në konsideratë që veprimtaria e programit të studimit mbështetet dhe në Rregulloren e po këtij programi në Universitetin partner e cila detajon mjaft mirë qëllimin⁷⁴, objektivat e formimit dhe mundësitë e punësimit, si dhe njohurite, aftësitë dhe qëndrimet që bën të mundur formimi në këtë program.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit zhvillohet në gjuhën italiane dhe përfshin në masën 80% të njëjtën kurrikul si në Universitetin e Barit⁷⁵, kusht që buron nga marrëveshja për diplomën e përbashkët.</p> <p><i>Bazuar në programin e studimit do të ishte e pëlqyeshme të ketë më shumë vend për lëndët që i përkasin shkencave sociale dhe humane, ndërsa informatika do të duhej të ishte lëndë bazë dhe jo me zgjedhje.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me pedagogët e programit, evidentuam që në në përfundim të lëndës/modulit, pedagogu analizon me studentët aftësitë dhe njohuritë e fituara, duke bërë përmbledhjen e koncepteve, diskutuar çështjet më të me studentët dhe orientuar ata në drejtim të aftësive që kërkohen më shumë nga tregu i punës.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në UKZKM, jashtë strukturës së programit mësimor, zhvillohen orë të hapura dhe seminare me personalitete të shkencës, drejtues të rëndësishëm të institucioneve të rëndësishëm në vend dhe të ftuar ndërkombëtarë⁷⁶.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë</p>	<p>Mësimdhënia synon që t’u krijojë studentëve një sërë kompetencash bazuar në dhënien e njohurive, aftësimin dhe krijimin qëndrimeve</p>

⁷² Evidenca Nr 17 Plani i programit të studimit bachelor “Ekonomi Ndërmarrje”

⁷³ Evidenca Nr 18 Rregullore e Programit të studimit bachelor “Ekonomi Ndërmarrje”

⁷⁴ Evidenca Nr 20 Dekreti i Këshillit të departamentit DEMDI të Universitetit të Barit

⁷⁵ Evidenca Nr 20 Dekreti i Këshillit të departamentit DEMDI të Universitetit të Barit

⁷⁶ Evidenca Nr 36 Lista e veprimtarive shkencore dhe didaktike me seminare dhe konferenca

kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	përmes mësimdhënies teorike dhe praktike, gërshetimit të leksioneve me seminarët, përdorimit të metodologjive të ndryshme të mësimdhënies dhe angazhimit të studentëve në orën e mësimi dhe jashtë saj me detyra praktika.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	UKZKM konsideron shumë të rëndësishme krijimin e një fryme të punës në grup me studentët dhe stafin akademik. Një kulturë e tillë përmirëson të gjitha proceset në institucion, përmirëson dhe procesin akademik dhe zhvillimin e kompetencave të domosdoshme për studentët që studiojnë ekonomi dhe që përgatiten për të punuar në mjedisin e organizatave, Aplikimi në projektet kërkimore të financuara nga universiteti është një dëshmi e punës në skuadër.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Universiteti mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimeve kërkimore ⁷⁷ dhe shkencore, mbështet dhe studentët në këtë drejtim ⁷⁸ . Gjithashtu, personeli është i informuar mbi strategjinë e zhvillimit të institucionit ⁷⁹ dhe të kërkimit shkencor. Gjatë vizitës në institucion, përmes bisedave me stafin akademik evidentuam që UKZKM nuk organizon ende një konferencë shkencore vjetore. <i>Marrëveshja e diplomave të përbashkta me Universitetin e Barit, mund dhe duhet parë dhe në aspektin e kërkimit shkencor, projekteve ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe të shkëmbimit të studentëve dhe pedagogëve në kuadrin e Erasmus+.</i>			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Në lidhje me mbështetjen e ideve inovative dhe të projekteve të kërkimit, brenda universitetit ka patur një inisiativë të mirë vlerësuese të projekteve më të mira të stafit akademik dhe marrja e një vendimi për mbështetjen financiare të tyre.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në lidhje me bashkëpunimet me universitete jashtë Shqipërisë dhe për mobilitetet për stafin dhe studentët, gjatë vizitës në institucion dhe takimit me personin përgjegjës të Zyrës së Projekteve dhe Ndërkombëtarizimit gjykojmë që janë ende në hapat e parë. <i>GJVJ mendon që për të gjithë mënyrën e krijimit dhe zhvillimit të UKZKM mund dhe duhet të ketë më shumë mobilitet studentësh dhe stafi, nisur nga Universiteti i Barit me të cilin kanë një partneritet të qenësishëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8

⁷⁷ Evidenca Nr 44 Rregullore për shpërndarjen e kontributeve universitare

⁷⁸ Evidenca Nr 32 Kontrata e bashkëpunimit të studentëve që marrin pjesë në punë kërkimore

⁷⁹ Evidenca Nr 16 Plani I Zhvillimit të Institucionit

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në lidhje me mbrojtjen e diplomës, Rregullorja e Fakultetit ⁸⁰ përmban: - kërkesa për përgatitja e temës së provimit, - seancat e diplomimit - certifikatat dhe vërtetimin e titullit të lëshuar Institucioni ka dhe një Rregullore e posaçme për diplomimin ⁸¹ , e specifikon të gjitha procedurat që duhen ndjekur.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në përputhje me Rregulloren e Fakultetit ⁸² dhe Rregulloren e Diplomimit strukturat përgjegjëse, personeli akademik dhe koordinatori i programit, udhëzojnë dhe mbështesin studentët në përgatitjen e temës së diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në Rregulloren e Diplomimit Komisioni i emëruar nga Rektori me propozimin e Dekanit të Fakultetit, vlerëson si ecurinë e tri viteve akademike dhe merr në konsideratë kreditet që i takojnë temës, duke konkluduar në një notë përfundimtare.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Gjatë vizitës në institucion, në takimin me pedagogët dhe studentët evidentuam që përgatitja e diplomës nga ana e studentit bëhet nën mbikëqyrjen dhe mbështetjen e pedagogut udhëheqës, por në të njëjtën kohë, koordinatori i programit dhe pjesa tjetër e stafit të departamentit është i gatshëm për t'i mbështetur. I gjithë procesi është në respektim të rregullores, por dhe të një raporti pedagog- student që vë në qendër studentin dhe nevojat e tij.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Pjesa empirike e punimit të diplomës realizohet përmes mbështetjes të udhëheqësit, stafit akademik, koordinatorit të programit dhe stafit administrative, nëse është e nevojshme.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e	Pedagogu udhëheqës asiston studentin në çdo fazë të punimit dhe garanton cilësinë e punimit dhe konfirmon dorëzimin e punimit për në komision.

⁸⁰ Evidenca Nr 15 Rregullore e Fakultetit

⁸¹ Evidenca Nr 49 Rregullore e Diplomimit

⁸² Evidenca Nr 15 Rregullore e Fakultetit

tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.				
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të mbrojtjes, studenti vlerësohet me notë.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Pas përfundimit të diplomës, në përputhje me Rregulloren e Fakultetit ⁸³ studentit u lëshohen dokumentat e mëposhtëm: - Certifikata e diplomës me notat e marra; - Suplementi i diplomës; - Dokumentat personale; - Pergamena.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti pajiset në përfundim të studimeve me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, kopjen zyrtare të programit/planit të studimit.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Në dosjen e dokumentave të studentit ruhen fotokopjet e të gjithë dokumentave origjinalë të lëshuar nga universiteti, por dhe e kopjet e dokumentave origjinale në momentin e hyrjes së tij në universitet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁸³ Evidenca Nr 15 Rregulore e Fakultetit

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës, mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Nga konsultimi me bazën dokumentare rezulton se:⁸⁴</p> <p>a) Dokumenti nr. 24, me emërtesë “<i>Dekret nr. 21 – Emërimi i anëtarëve të dept.; Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale</i>” ka miratuar me firmën e Rektorit përbërjen e departamenteve përgjegjëse për ofrimin e programit subjekt ri-akreditimi për vitin akademik 2020-2021. Ky dokument sjell si referenca për këtë miratim, vendimin e Senatit Akademik me dt. 28.07.2020 dhe aprovimin e Këshillit të Administrimit më 30.07.2020. Vetë dokumenti nr. 24 përmban datën 09.10.2019 dhe nr. protokolli 349. Duhet të ketë ndonjë gabim në përpilimin ose ngarkimin e materialit, për faktin se një dokument me datë më të hershme sjell si referenca dhe mbështetet mbi dokumente me data të mëvonëshme. Është gjithsesi e pamundur të ndiqet kronologjia, nëse kjo datë përbën një lapsus, sepse dokumentet e cituara si referenca nuk referojnë numra protokolli dhe as nuk gjenden në bazën dokumentare të depozituar në dosjen virtuale në e-ASCAL.</p> <p>b) Nga kryqëzimi i të dhënave⁸⁵ rezulton se nuk është ngarkuar në dosjen virtuale në sistemin e-ASCAL, CV-ja e një pedagogu të programit, Dekanit të fakultetit, pedagog i lëndës “E drejtë publike” (viti 1, semestri 1). Nga CV e dekanit në faqen <i>online</i> të UKZKM, konstatohet se ajo nuk është përditësuar përtej vitit 2019. Po kështu, nuk është ngarkuar në dosjen virtuale edhe CV e koordinatorës së programit të studimit dhe pjesës më të madhe të stafit ndihmës akademik e administrativ⁸⁶. Një pjesë e mirë e CV-ve të stafit akademik gjenden gjithsesi në faqen <i>online</i> të UK ZKM.</p> <p>c) Nga kryqëzimi i të dhënave⁸⁷ konstatohet se për 23 syllabuse të depozituara për vitin akademik 2020-2021, janë 18 pedagogë-staf</p>

⁸⁴ Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua dokumenteve nr. 1, 21, 22, 24, 27, 29, 57 dhe vizitës në terren të dosjeve fizike dhe virtuale të stafit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore.

⁸⁵ Përmbajtur në dok. nr. 21 “*Syllabuset e programit*”, dok. 22 “*CV-të e stafit akademik*” dhe dok. nr. 27 “*Tabelat përmbledhëse*”.

⁸⁶ Vetëm 2 CV nga 23 punonjës të raportuar në tabelën nr. 2, të dok. nr. 27.

⁸⁷ Përmbajtur në dok. nr. 21 “*Syllabuset e programit*”, dok. 22 “*CV-të e stafit akademik*” dhe dok. nr. 27 “*Tabelat përmbledhëse*”.

akademik efektiv që i lëvrojnë ato për vitin 2020-2021⁸⁸. Për këta 18 pedagogë, janë depozituar 17 CV (një mungon, sikurse theksuar në germën “b” më lart).

- 9 nga 17 CV janë të përditësuara deri në vitin 2020-2021;
- 5 nga 19 janë të përditësuara deri në vitin 2019;
- për 2 nga 19 CV nuk gjenden të dhëna të përditësuara përtej viti 2016, dhe
- për 1 CV nuk ka të dhëna direkte ose indirekte për të nxjerrë datën më të fundit të përditësimit.

d) Referuar pedagogëve të jashtëm⁸⁹ asnjë prej tyre nuk rezulton si pedagog i aktivizuar në syllabuset e paraqitura⁹⁰. CV-të e tyre paraqesin angazhim pranë programit të studimit, në lëndë që në syllabuse lëvrohen nga pedagogë të tjerë (efektivë). Ndoshta syllabuset zhvillohen nga dy ose më shumë pedagogë, por nuk ka gjurmë për këtë dhe rrjedhimisht duhen plotësuar më mirë syllabuset.

Nga 7 pedagogë të jashtëm⁹¹ gjenden CV e 5 prej tyre⁹². Nga këto:

- 1 CV është e përditësuara deri në 2020;
- 2 CV deri në 2019, dhe;
- 2 CV deri në 2017.

e) Nga vizita në terren, GVJ vizitoi Zyrën e Burimeve Njerëzore për të konstatuar, brenda mundësive, kërkesat e këtij kriteri. Zyra e BNJ mban dokumentacion në formë fizike dhe elektronike. Dosja elektronike e dy pedagogëve të shqyrtuar rastësisht, përmbante një pjesë të të dhënave⁹³. Dosjet fizike të dy pedagogëve, të përzgjedhura rastësisht, përmbanin dokumentacion të plotë sa i përket kërkesave të dok. nr. 57, por disa dokumente për një pedagog të jashtëm (diplomat, lista e notave) nuk ishin të noterizuara, por fotokopje të thjeshta, ndërsa një pjesë tjetër (librezë shëndeti, CV) nuk ishin të përditësuara për vitin akademik 2020-2021.

f) Në dokumentin shtesë që institucioni depozitoi me kërkesë të GVJ-së, pas vizitës në subjekt, gjenden të dhëna të hollësishme dhe të përditësuara për aktivitetin kërkimor-shkencor të pedagogëve. Dokumenti për këto të dhëna mban datën 01 Qershor 2021 dhe

⁸⁸ Në tabelën përmbledhëse nr. 2 rezultojnë 24 pedagogë efektivë, por disa prej tyre nuk rezultojnë në asnjë syllabus.

⁸⁹ Në dok. 22 gjenden CV të pedagogëve të jashtëm (me kontratë) dhe në dok. nr. 27 (tabela përmbledhëse) ata cilësohen si pedagogë të jashtëm.

⁹⁰ Dok. nr. 21

⁹¹ Të raportuar në dok. nr. 27.

⁹² Dok. nr. 22.

⁹³ Listuar në dok. nr. 57 “Dokumentacioni për personelin akademik”, si të detyrueshme.

	<p>duket i përpiluar vetëm për qëllime të ri-akreditimit të këtij programi, pra nuk është raport periodik.</p> <p>Për sa më lart, kriteri konstatohet i përmbushur pjesërisht dhe sugjerohet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentit⁹⁴ nr. 13 “Statuti i UKZKM”, i vitit 2018, rezulton se ky dokument shprehet për çështje të rekrutimit të personelit akademik dhe konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Neni 5, gërma “h”; b) Neni 13, pika 1, gërma “i” dhe “j”; c) Neni 15, pika 3, gërma “f”; d) Neni 32, gërmat “f” dhe “h”; e) Neni 38, pika 7. <p>Aspektet e rekrutimit të personelit akademik, parashikuar dhe rregulluar nga këto nene, janë në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe e detajojnë optimalisht atë. Nga konsultimi me dok. nr. 15 “Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Politike e Sociale” rezulton se ky dokument shprehet, në detajim të Statutit, për çështje të rekrutimit të stafit akademik dhe konkretisht, neni 6, pika 2, gërma “i”.</p> <p>Dokumenti nuk përmban datën e miratimit dhe nr. e protokollit, që në fakt është e metë e një pjese të dokumentacionit të depozituar në e-ASCAL nga UKZKM.</p> <p>Nga konsultimi me dok. nr. 57 “Rregullore për procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore” rezulton se paragrafi 3.1 i kësaj rregulloreje “Rekrutimi i punonjësve”, parashtron kërkesat për procedurën e rekrutimit. Procedura, në disa hallka të saj, nuk ka të specifikuar strukturën përgjegjëse për mbarëvajtjen e saj.</p> <p>Rregullorja mban dt. 10.09.2020, nr. e prot. 85 dhe është firmosur vetëm nga Administratori i UKZKM. Si një rregullore e përbashkët, që rregullon procedurat e menaxhimit të stafit akademik dhe atij administrativ, kjo rregullore duhet të firmosej edhe nga përfaqësuesi i Senatit Akademik, Rektori i UKZKM, në përputhje me nenin 13, gërma “c”, të Statutit, duke lënë kështu gjurmë të miratimit të saj nga kjo strukturë akademike. Në paragrafin 6.2 të kësaj rregulloreje përmendet si referencë edhe Rregullorja e brendshme institucionale për personelin akademik, por një rregullore e tillë nuk gjendet në dosjen përkatëse, depozituar në e-ASCAL. Gjithashtu, për një vlerësim më të mirë të dizenjimit të procedurave të rekrutimit, do të ishte me vlera konsultimi i Kodit Etik të institucionit dhe Rregullores së</p>

⁹⁴ Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ shqyrtoi dokumentet nr. 1, 13, 15, 56 dhe 57 të depozituara në e-ASCAL, sikurse edhe Ligjin 80/2015. GVJ tentoi të konsultonte edhe dok. nr. 18 “Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje”, por ky dokument rezultoi të mos ishte rregullore, por program i studimit, firmosur nga koordinatorja e programit.

	<p>Brendshme të Bordit të Administrimit, dokumente këto të parashikuara respektivisht në nenin 13, pika 1, gërma “b” dhe nenin 32, gërma “i” e Statutit Institucional. Të dyja këto dokumente nuk gjenden në dosjen përkatëse në e-ASCAL.</p> <p>Sa i përket zbatimit të procedurave të dizenuara në dokumentet e mësipërme, GVJ konsultoi dokumentin e vetëm që përmbante të dhëna për këtë aspekt, atë me nr. 56, referuar edhe në RVB. Nga konsultimi me këtë dokument rezultoi se:</p> <p>a) Në të janë përfshirë dy njoftime për rekrutim. Njëri mban dt. 24.09.2019 dhe është shpallje për rekrutimin e dy punonjësve akademikë, ndërsa tjetri mban dt. 06.12.2016 dhe është shpallje për rekrutimin e një koordinatori mësimor, të dyja shpalljet për Fakultetin që ofron programin e studimit.</p> <p>b) Në njoftimin e parë mungon përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi, që është një kërkesë eksplicite, e detyrueshme, e parashtruar në Rregulloren e procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore. Gjithashtu, në njoftim specifikohet që aplikimet t’i përcillen Dekanit të Fakultetit dhe jo Zyrës së Burimeve Njerëzore, që përgjithësisht është një praktikë standarde rekrutimi. Po kështu, shpallja në fund mban emrin e Dekanit të Fakultetit, ndërkohë që procedura standarde kërkon emrin e institucionit.</p> <p>c) Në njoftimin e dytë, aplikimi duhet të dorëzohet pranë Sekretarisë së Presidencës së Fondacionit ZKM dhe shpallja në fund mban emrin e Presidentit, të cilit duhet t’i drejtohet edhe kërkesa për aplikim. Njoftimi është i plotë në lidhje me kërkesat që parashtron Rregullorja, ndonëse daton më herët se ajo dhe se njoftimi i vitit 2019, por sërish jo në përputhje me praktikën standarde të rekrutimit.</p> <p>d) Në dokumentin e depozituar pas vizitës në terren, për njërin nga shpalljet e mësipërme (24.09.2019) janë depozituar edhe Urdhëri i Rektorit për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit <i>ad hoc</i>, sikurse edhe Vendimi i këtij Komisioni për përzgjedhjen e dy kandidatave nga tre aplikime të depozituara.</p> <p>Për sa më lart, edhe pas vizitës në terren, GVJ arriti të krijojë një bindje të arsyeshme se zbatimi i procedurave të rekrutimit të stafit akademik, të parashikuara në Statut dhe Rregullore, janë në përputhje të kënaqshme me aktet e vetë institucionit, por gjithsesi ka ende vend për përmirësim, si nga pikëpamja rregullative, ashtu edhe ajo protokollare.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme</p>	<p>Në dokumentin⁹⁵ nr. 57 “Rregullore e procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore”, gjenden procedurat për të gjitha hapat nëpër të</p>

⁹⁵ Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua sërish dok. nr. 56 dhe 57.

<p>e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>cilat kalon procesi i rekrutimit. Vetë rregullorja mund të ketë nevojë për përmirësim, sepse sa i përket procesit të rekrutimit nuk identifikohet qartë struktura përgjegjëse për realizimin e çdo hallke të procesit. Kështu, procesi i parë në procedurën e rekrutimit është “përcaktimi i vendit të punës dhe kriterëve përkatës”, por Rregullorja nuk parashikon se cila strukturë e realizon këtë. Është kritike që komisioni apo struktura që propozon dhe përcakton kriteret përzgjedhëse të mos jetë pjesë e Komisionit vlerësues <i>ad hoc</i> të ngritur nga Rektori, për të shmangur çdo problem etik që mund të lindë nga konflikti i interesit dhe ky filtër duhet të dalë i qartë në Rregullore. Mungesa e strukturës përgjegjëse vijon të evidentohet edhe në hallkën vijuese (germa “b”) të procesit të rekrutimit (shpallja e vendit të punës). Në rastin e trajtuar në kriterin e mësipërm, shpallja bëhet nga Dekani i njësisë kryesore, ndërkohë që rregullat burokratike dhe praktikat standarde e kërkojnë që shpalljen ta bëjë njësi ekzekutive që është Zyra e Burimeve Njerëzore, ose Universiteti në përgjithësi. Në hallkat e tjera (germat “c”, “d” dhe “e”) janë përcaktuar strukturat përgjegjëse. Gjithashtu, sikurse evidentohet edhe në Rregulloren e Fakultetit që ofron programin e studimit apo materiale të tjera, dokumentet nuk përmbajnë strukturën që emeton dokumentin, apo nr. e protokollit dhe datën e emertimit, në kundërshtim kjo me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor. Në konsultim me dok. nr. 56, që përmban shpalljet për vende të lira pune në pozicione akademike e ndihmës-akademike, konstatohet se kriteret e shpallura nuk përfshijnë elementë të karakterit etik. Për shembull, kriteret nuk specifikojnë kërkesa për gjendjen penale të aplikantit, masat disiplinore që tolerohen apo nuk tolerohen, etj. Sugjerohet plotësimi i procedurave me sa konstatuar më lart.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret e përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga kryqëzimi i të dhënave të përmbajtura në dok. nr. 22 (CV-të e stafit akademik) me dok. nr. 21 (syllabuset e programit të studimit)⁹⁶ konstatohet përputhje e plotë e profilit dhe kualifikimit të pedagogut me lëndën që ai/ajo lëvtron për nivelin përkatës të programit. Në përputhje me nenin 59, pika 6 e Ligjit 80/2015, të gjithë pedagogët e angazhuar në programin e aplikuar për akreditim mbajnë gradë minimalisht të ciklit pasardhës kundrejt programit ku janë angazhuar në mësimdhënie. Pra nga pikëpamja e rezultatit që prodhon, procedura e rekrutimit është efektive.</p> <p>Sa i përket mbështetjes së kësaj procedure në kriteret:</p> <p>a) Për pedagogët e huaj, referuar dok. nr. 29, ku përmbahen emrat e stafit akademik italian të angazhuar në vitet akademike 2016-2017, 2017-2018 dhe 2019-2020, bëhet referencë për një “protokoll ekzekutiv”, që mundëson këtë angazhim. Ky protokoll ekzekutiv</p>

⁹⁶ Në vlerësimin e këtij kriteri GVJ shqyrtoi dokumentet nr. 1, 5, 21, 22, 29, 56 & 57 të depozituara në e-ASCAL.

	<p>parashihet në dok. nr. 5 “Marrëveshje midis Univ. Bari dhe UK ZKM”, neni 2, me dt. Mars 2019, por vetë dokumenti i protokollit ekzekutiv nuk gjendet në dokumentet e ngarkuara në e-ASCAL, për të gjykuar mbi përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes.</p> <p>b) Për pedagogët shqiptarë, praktika dokumentare që i referohet, përzgjedhjes së tyre në përmbushje të kriterëve u depozitua në e-ASCAL pas vizitës në terren. Në bazë të kësaj praktike, konstatohet përzgjedhja korrekte referuar kriterëve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Statuti institucional⁹⁷, për aq sa e lejon hierarkia e këtij dokumenti strategjik, shprehet lidhur me kërkesat e këtij kriteri në:</p> <p>a) Kreun 2, neni 10, pika 2; b) Kreun 2, neni 19, pika 2, germa “a”; c) Kreun 3, neni 36, pika 1 & 2; d) Kreun 5, neni 54, pika 1.</p> <p>duke garantuar <i>de jure</i> krijimin e mjedisit dhe mundësive të barabarta e të përshtatshme që personeli të përmbushë detyrat profesionalisht. Nga konsultimi me rregulloren e bibliotekës, cituar edhe në RVB si një dimension i këtij kriteri, konstatohen rregulla të detajuara për aksesin në literaturë, ndonëse mbetet e paqartë data e dokumentit dhe njësia emetuese e tij. Vetë rregullorja citon se mbështetet në nenin 50 të Statutit institucional, ndërkohë që neni 50 i Statutit të depozituar në e-ASCAL dhe publikuar në faqen <i>online</i> të UK ZKM bën fjalë për provimet vjetore dhe ato të diplomës, pa iu referuar në asnjë rast bibliotekës. Kjo nënkupton mospërditësimin e aktit. Nga vizita inspektuese në terren, mjediset e bibliotekës, virtuale dhe fizike, konsiderohen optimale. Nga konsultimi me rregulloren e përdorimit të pajisjeve informatike konstatohen rregulla të qarta për ruajtjen e sigurisë, etikës dhe profesionalizimit në vendin e punës, gjatë</p>

⁹⁷ Për vlerësimin e këtij kriteri GVJ iu referua Kodit të Punës në RSH, Statutit Institucional dhe akteve të tjera të dala në zbatim të tij dhe që përmbaheshin në dosjen e e-ASCAL (Rregullores së fakultetit, Rregullores së bibliotekës, Rregullores së përdorimit të pajisjeve informatike, Rregullores për kontributet mbi kërkimin shkencor dhe Rregullores së procedurave të menaxhimit të BNJ).

Rregullore dhe dokumente të tjera që mund të kishin lidhje me kërkesat e këtij kriteri, si Kodi i Etikës, Kodi i Disiplinës, Rregullorja e Universitetit, Rregullorja e Fondacionit ZKM, Rregullorja e Bordit të Administrimit, etj., dokumente këto të cituara në Statut, nuk u konsultuan, për shkak se nuk gjenden në dosjen e e-ASCAL.

	<p>shfrytëzimit të pajisjeve, platformave dhe aplikacioneve kompjuterike. Rregullorja është e përditësuar, ku versioni i katërt i saj mban datën “shtator 2020”. Nga vizita në terren konstatohen investime të konsiderueshme në <i>hardware</i> dhe <i>software</i> kompjuterikë, për të realizuar me profesionalizëm detyrat e ngarkuara.</p> <p>Nga konsultimi me rregulloren e kontributeve për kërkimin shkencor konstatohen rregulla për shpërndarjen e fondeve të UKZKM lidhur me kërkimin shkencor. Përgjithësisht rregullat janë të qarta dhe jodiskriminuese. Dokumenti sërish nuk ka datë dhe strukturën emetuese të tij. Ai është firmosur vetëm nga Rektori, ndërkohë që përgjatë dokumentit citohen detyra dhe përgjegjësi kyçe për Bordin (Këshillin) e Administrimit. Si i tillë dokumenti duhet firmosur edhe nga Administratori. Nga konsultimi me rregulloren e procedurave të menaxhimit të BNJ konstatohet se dokumenti përmban rregulla mbi rekrutimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, shkeljet, etj. Përgjithësisht dokumenti parashtron rregulla dhe procedura që synojnë të krijojnë një mjedis të përshtatshëm pune dhe me bazë performancën profesionale. Një paragraf i këtij dokumenti dhe konkretisht ai 7.2, që shprehet mbi orët jashtë orarit, mbetet i paqartë për GVJ. Ky paragraf shprehet se: “Për orët jashtë orarit, punëmarrësit kërkojnë autorizim nga punëdhënësi ...” dhe “Në rastin kur orët jashtë orarit nuk janë të autorizuar, punonjësi nuk ka të drejtë të kërkojë kompesimin e tyre. Përkundrazi detyrohet të japë shpjegime për motivet që e kanë shtyrë të punojë jashtë orarit të tij të punës.” Në fakt, sipas Kodit të Punës, në nenet 89 dhe 90, specifikohet se është punëdhënësi që i kërkon punëmarrësit të kryejë orë shtesë pune dhe jo anasjelltas. Rrjedhimisht, duhet të jetë punëdhënësi ai që duhet të plotësojë formularin e autorizimit si kërkesë për orët shtesë që duhet të kryejë punëmarrësi e më pas punëmarrësi të plotësojë listë-prezencën për këto orë shtesë, në përputhje me këtë autorizim dhe gjurmët e kartës së timbrimit. Paragrafi 7.2 ka nevojë të modifikohet në përputhje me Kodin e Punës, për t’i mundësuar personelit kryerjen e detyrave në mënyrë ligjore dhe profesionale. Sikurse theksuar më lart, për aq kohë sa dokumenti parashihet rregulla e procedura edhe për stafin akademik, ai duhet të firmoset edhe nga Rektori, jo vetëm nga Administratori i UK ZKM.⁹⁸</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit⁹⁹ rezulton se institucioni e ka të parashikuar dhe të rregulluar në letër këtë aspekt të menaxhimit të burimeve njerëzore që punojnë për të. Gjithsesi, nga shqyrtimi i dok. nr 36, përmendur në RVB si referencë për përmbushjen në realitet të</p>

⁹⁸ Në dokumentet e depozituara në e-ASCAL nuk gjendet një kontratë tip pune për personelin akademik dhe atë administrativ, për të gjykuar mbi detyrimet e UK ZKM lidhur me kërkesat e këtij kriteri.

⁹⁹ Për vlerësimin e këtij kriteri GVJ iu referua dok. nr. 1, 13, 15, 27, 31, 36, 37, 44, 57 dhe 58.

<p>administron programin e studimit.</p>	<p>këtij kriteri, “Lista e veprimtarive shkencore e didaktike”, rezulton se dokumenti i referohet veprimtarive me fokus studentët dhe jo personelin.</p> <p>Nga shqyrtimi i dok. nr. 31 “Raporti vjetor i aktivitetit didaktik nga Dekani”, që mban datën 10.09.2019, rezulton se dokumenti është hartuar mbi bazën e tri raportimeve vjetore që kanë bërë drejtuesit e departamenteve që ofron programin e studimit, sikurse edhe mbështetur në planin 3-vjeçar 2019-2021 për këtë Fakultet. Ky raport i Dekanit është i përgjithshëm dhe në të nuk gjenden gjurmë konkrete të kualifikimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të mëtejshëm profesional të stafit akademik që mbulon programin e studimit. Raporti nuk përmban tregues apo indikatorë të performancës dhe masën e realizimit të tyre për vitin raportues. Gjithashtu ai nuk përmban strukturën së cilës i drejtohet. Në sistemin e-ASCAL nuk janë depozituar raportimet e tri drejtuesve të dept. (për këtë vit apo për çdo periudhë tjetër), sikurse nuk ka asnjë raport nga Zyra e BNJ për vlerësimin e performancës dhe avancimin profesional të stafit administrativ. Këto raporte janë të detyrueshme në përputhje me Statutin dhe aktet e tjera rregullatorë të nxjerra në zbatim të tij.</p> <p>Në sistemin e-ASCAL, pas vizitës në terren, u depozituan dokumente për aktivitetet shkencore të realizuara nga institucioni lidhur me kërkesat e këtij kriteri. Në dokumentin “Raport vjetor i aktivitetit të Zyrës së Projekteve” me dt. 17.09.2020, tregohen fashat e programeve që UK ZKM ofron për financim për stafin akademik të dept. Gjithashtu, në këtë raport jepet referenca për projektet e mobilitetit në Itali dhe Poloni, etj. Sa i përket angazhimit financiar mungojnë tabelat financiare (balance, preventivë, etj) për të gjykuar se sa ishte buxheti i alokuar për kërkim shkencor, si ndahej ai sipas zërave dhe prioriteteve dhe në çfarë forme shpërndahej konkretisht.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.</p>	<p>Kërkesat e këtij kriteri marrin akoma edhe më shumë rëndësi në kushtet e pandemisë në të cilat u zhvillua mësimi në dy vitet e fundit akademike. Në dosjen e depozituar në sistemin e-ASCAL nuk gjenden gjurmë të një manuali apo rregulloreje për mësimdhënien në kushtet e COVID-19. Gjithsesi, nga vizita në terren, stafi akademik pohoi se ka marrë trajnime intensive për metodat e mësimdhënies në distancë, përmes teknologjive të reja, të zhvilluara për këtë qëllim.</p> <p>Investimet institucionale në shtimin e infrastrukturës kompjuterike <i>hard</i> dhe <i>soft</i> duken se e mbështesin këtë qasje ndaj teknologjisë dhe metodave inovative të mësimdhënies. Nga konsultimi me dok. nr. 57, parashihen trajnime për stafin administrativ dhe atë akademik lidhur me aspekte IT dhe të shkëmbimit të eksperiencave me kolegë të huaj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për</p>	<p>Nga akreditimi i mëparshëm ishte lënë si detyrë: “<i>një shpërndarje më e balancuar e ngarkesës mësimore, përgjatë vitit akademik, për</i></p>

përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.

studentët e këtij programi studimi". Nga konsultimi me dok. nr. 1, RVB shprehet se: "UK ZKM ka përmbushur rekomandimet e Këshillit të Akreditimit, në mënyrë të veçantë atë për të garantuar një shpërndarje më të ekuilibruar të ngarkesës mësimore gjatë vitit akademik.", por pa dhënë asnjë referencë për ndryshimet e ndërmarra dhe shkallën e kësaj përmbushjeje. Përgjatë vizitës inspektuese, pyetjes eksplicite të GVJ-së për mënyrën se si është vënë në jetë ky rekomandim, GVB iu përgjigj se zgjidhja është realizuar përmes:

- a) Numrit të profesorëve, duke kombinuar pedagogët e brendshëm me ata të ftuar;
- b) Krijimi të dept. për menaxhimin më të mirë të stafit akademik, dhe;
- c) Publikimit të kalendarit vjetor online për shpërndarjen.
- d) Për dy vitet e fundit akademike, përmes mësimdhënies *online*.

Shpërndarja e ngarkesës përgjatë vitit duket e barabartë midis semestrave¹⁰⁰. Sa i përket shpërndarjes së ngarkesës midis leksioneve dhe seminareve, nga tabela rezulton se e gjithë ngarkesa realizohet përmes leksioneve. Nga kryqëzimi me të dhënat e përmbajtura në syllabuse, disa lëndë nuk i specifikojnë orët mësimore në leksione dhe seminare, ndërsa disa të tjera shprehen se kryejnë seminare, por të dhënat e tabelës 10 i paraqesin ato vetëm me ngarkesë në leksione. Nga vizita inspektuese në terren, regjistrat e prezencës që plotësohen nga pedagogu konfirmojnë ngarkesën e realizuar vetëm përmes leksioneve. Gjithashtu, edhe pyetjes direkte gjatë vizitës: "Se si është e ndërtuar lënda midis leksione/seminare/detyra?", stafi akademik dhe drejtues iu përgjigj se: "Nuk kemi parametra, sepse lëndët janë të ndryshme. Në vitin 1 janë leksione në auditor, por nuk përjashtohen seminarët që i bëjnë ekspertët e jashtëm".¹⁰¹

Nga konsultimi me dok. nr. 27 "Tabelat përmbledhëse", detyrimi ligjor për raportin 70/30 në përqindje i pedagogëve të brendshëm kundrejt atyre të jashtëm (cilësuar në VKM nr. 418, dt. 10.05.2017, pika 2, gërma "b", niveli "ii") përmbushet plotësisht për të gjithë 6-vjeçarin nga akreditimi i fundit (2015-2021).

Nga takimet me përfaqësues të NjBSC, Zyrës së BNJ, Zyrës së Projekteve, Zyrës së Këshillimit të Karrierës, Sekretarisë, etj., konstatohen nevoja për angazhim/punësim shtesë të stafit akademik e administrativ, për një investim optimal të burimeve njerëzore në shërbim të programit të studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

¹⁰⁰ Referuar tab. nr. 10 në dok. nr. 27.

¹⁰¹ Përmbajtur në shënimet e koordinatorit gjatë vizitës inspektuese në dosjen në ASCAL.

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar dok. nr. 27, tabelave nr. 16 dhe 17 , inspektimeve në terren dhe bisedave me studentët e pedagogët, kriteri plotësohet në përputhje me kërkesat ligjore (VKM nr. 418, dt. 10.05.2017 dhe Udhëzimit nr. 1, dt. 14.01.2020 të titullarit të MASR) dhe madje tejkalohet. Në përputhje me risqet më të fundit të pozura nga tërmeti dhe pandemia, institucioni ka marrë masat e duhura antisizmike dhe distancimit fizik e higjienës së shtuar.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Referuar vizitës në terren dhe njohurive specifike të ekspertëve të jashtëm, kërkesat e këtij kriteri plotësohen dhe tejkalohen në terma absolutë dhe relativë nga subjekti kandidat për ri-akreditim në këtë program. Infrastruktura <i>hard</i> dhe <i>soft</i> e subjektit është bashkëkohore, e licensuar konform ligjeve dhe në përputhje me nivelin e njohurive të stafit akademik e ndihmës-akademik. U konstatuan një numër i mjaftueshëm kompjuterësh, projektorësh, sisteme audio dhe routerash për lidhje në Internet. Interneti në Ethernet dhe Wi-Fi ishte funksional.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga inspektimi në terren u konstatuan <i>softe</i> të licensuara për kryerjen me sukses të programit mësimor. Kompjuterët ishin të parametrave optimalë për nevojat e punës dhe mësimdhënies. Subjekti dispononte të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme, sikurse edhe rregulloren përkatëse për përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Nga inspektimi në terren, subjekti kishte laboratorë të pajisur më së miri në këtë drejtim, për programin për të cilin ka aplikuar për riakreditim.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me	Institucioni e shtrin aktivitetin e tij në disa godina, të cilat janë të pajisura me të gjitha hapësirat, aparaturat dhe dijen e nevojshme të stafit për t'i operuar ato në funksion të mësimdhënies, praktikave

institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	profesionale dhe çdo aktiviteti tjetër me natyrë akademike, profesionale e praktike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga inspektimi në terren i mjediseve të subjektit dhe intervistat me studentët, konstatohet se UK ZKM disponon dhe vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore brenda mjediseve të tij, sikurse edhe bibliotekën virtuale, me kredenciale personale të studentit për login. Rregullorja e bibliotekës mund të ketë nevojë për përditësim.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga inspektimi në terren dhe konsultimi me dok. nr. 28 "Lista e librave të sektorit", konstatohet se kërkesat e këtij kriteri për tipet e ndryshme të literaturës fizike përmbushen plotësisht.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat <i>on-line</i> të fushës së programit të studimit.	Subjekti, sikurse është cituar vazhdimisht më lart, disponon dhe ofron akses <i>online</i> për studentët e tij në biblioteka virtuale, për të cilat paguan vetë, duke ua ofruar pa pagesë studentëve të programit të studimit.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë	Nga pikëpamja e infrastrukturës teknologjike, UK ZKM është për t'u marrë shembull. Biblioteka është e pajisur me programe dhe pajisje të tjera që bëjnë të mundur shkarkimin, printimin, analizimin dhe raportimin apo dërgimin e informacioneve të nevojshme.

shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.									
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga dokumentet e konsultuara nuk identifikohet një plan i tillë i detajuar, qoftë nga Rregullorja e Bibliotekës, qoftë nga ajo e Kontributeve për kërkimin shkencor. Po kështu, nuk gjendet asnjë dokument financiar në dosjen e e-ASCAL që të tregojë alokimin e kaluar dhe preventiv të fondeve për këtë qëllim. Në RVB, për këtë kriter, është sjellë si referencë dok. nr. 38 “Lista e librave të sektorit”, por ky dokument përmban vetëm titullin e botimit, ISBN dhe emrin e autorit. Ai nuk është një raport apo plan për respektimin e kërkesave të këtij kriteri. Po kështu, në RVB, standardi IV.6, kriteri 5, është sjellë si ilustrim një tabelë financiare që së pari nuk është e qartë se kujt periudhe kohore i përket apo referohet dhe së dyti, që nuk parashikon në mënyrë eksplicite fonde të alokuara për pasurimin dhe përditësimin e bibliotekës. <i>Për sa më lart është e pamundur të konfirmohet përmbushja e kërkesave të këtij kriteri.</i>								
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Referuar dok. nr. 39 “Rregullore e bibliotekës”, oraret e ofrimit të shërbimit fizik dhe <i>online</i> të saj janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për studentët që duan të konsultojnë botimet që përmbahen në të. Po kështu, nga vizita inspektuese në terren, kapaciteti mbajtës i bibliotekës fizike ishte mëse i mjaftueshëm për 120 studentë njëkohësisht dhe materiali me të cilën ishte dizenuar dhe ndërtuar ajo minimizonte akustikën e brendshme dhe të jashtme. Biblioteka virtuale, duke shfrytëzuar Internet me lidhje të shpejtë, jepte mundësi për aksesim në çdo orë të ditës, veçanërisht e nevojshme kjo në kushtet e mesimdhënies <i>online</i> , përgjatë pandemisë.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi	Nga dokumentacioni i shqyrtuar ¹⁰² rezulton se institucioni ka ngritur të gjitha strukturat e nevojshme menaxheriale të drejtimit akademik dhe administrativ në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e dala në zbatim të tij. Këto struktura administrojnë informacionin akademik i cili, nga konspektimi i regjistrimit të studentëve, mbahet i plotë, me kujdes dhe në përputhje me procesverbalet dhe regjistrat e rezultateve

¹⁰² Për vlerësimin e këtij kriteri, ekspertët konsultuan kryesisht dok. nr. 1, 13, 54 dhe 84 nga dokumentet e deponuara në e-ASCAL, si edhe takimin me përfaqësuesen e sekretarisë mësimore.

<p>deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>të lëndëve përkatëse; sikurse administrojnë edhe informacionin administrativ, që përmban kontratën me studentin, numrin e matrikullimit dhe dokumente të tjera të natyrës administrative e financiare. Ruajtja dhe përditësimi i këtyre informacioneve bëhet manualisht dhe elektronikisht, në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe statutin institucional e Rregulloren e sekretarisë mësimore.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumenteve dhe vizita në zyrën e burimeve njerëzore, sikurse parashtruar edhe në plotësimin e kriterëve të mësipërme, konstatohet se menaxhimi i brendshëm mban dokumentacion mbi stafin akademik dhe jo akademik, sikurse edhe pedagogëve të ftuar për realizimin e programit. Ky dokumentacion ruhet manualisht dhe elektronikisht.</p> <p>Mbetet për t'u përmirësuar plotësimi elektronik i bazës dokumentare për personelin, sepse nga dy dosje të inspektuara me zgjedhje, rezulton se informacioni për pedagogët është bazik dhe nuk reflekton informacionin e përmbajtur në dosjen fizike. Po kështu duhet përmirësuar përditësimi i informacionit në format fizik dhe elektronik dhe, nga konsultimi me dok. nr. 27, "Tabela përmbledhëse", duhet të plotësohet dhe përditësohet aktiviteti i personelit akademik lidhur me kërkimin shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga testimi që iu bë përgjatë vizitës së ekspertëve aksesimit të informacionit dhe nivelit të këtij aksesimi, konstatohet se informacioni dhe dokumentet për studentët e stafin akademik të angazhuar në programet e studimit të aplikuar për akreditim, aksesohen sipas hierarkisë dhe funksioneve menaxheriale. Kështu, studentët kanë akses për pedagogët dhe anasjelltas në nivele akademike, ndërkohë që strukturat administrative kishin akses tek dy palët e mësipërme në lidhje me aspektet financiare dhe të tjera të natyrës administrative.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizita në terren, ekspertët konstatuan prezencën e platformave virtuale të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit, të përmirësuar edhe për shkak të kushteve të diktuar nga pandemia. Platformat ishin të personalizuar sipas funksionit: veçmas për anën akademike dhe veçmas për atë administrative të komunikimit të studentëve respektivisht me personelin akademik dhe atë administrativ.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të</p>	<p>Nga dok. nr. 1¹⁰³ është e vështirë të nxirret një konkluzion mbi përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri nga GVJ. Kjo edhe sepse plotësimi i RVB-së nuk është bërë nominalisht për çdo kriter, por në grup për krejt standardin, pa diferencuar se cilat përgjigje i përkasin</p>

¹⁰³ Për plotësimin e kërkesave të këtij kriteri, GVJ konsultoi dok. nr. 1, 13, 34 dhe 88 të dosjes së depozituar në e-ASCAL nga UK ZKM.


<p>dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>kujt kriteri, duke e ekspozuar kështu materialin ndaj riskut të interpretimit jo nominal (zë për zë) të tij.¹⁰⁴</p> <p>Nga dok. nr. 13 “Statuti institucional”, neni 22 i tij ngarkon kryesisht NjBSC-në për kontrollin e menaxhimit të Universitetit dhe aktiviteteve të tij për arritjen e objektivave institucionale. Nga konsultimi me bazën dokumentare të depozituar në ASCAL, fillimisht nuk gjendej asnjë raportim nga NjBSC. Pas vizitës në terren, me kërkesën e GVJ, në dokumentet shitesë të depozituara përmbahet një raport i kësaj Njësie për vitin akademik 2017-2018. Gjithsesi kërkesa e GVJ-së ishte për të paktën 3 (tre) raportet më të fundit të kontrollit të cilësisë së kësaj Njësie, edhe sepse Statuti dhe aktet e tjera rregullatorë (dok. nr. 88 “Rregullore e NjVBC) cilësojnë në mënyrë eksplicite raportimin periodik, vjetor të kësaj njësie. Nga të dhënat e këtij raporti nuk konstatohen gjurmë të monitorimit në kohë reale të aktiviteteve akademike e administrative. Raportimet e këtij materiali, sikurse tregohet në metodologjinë e përshkruar prej tij (në fund të fq. 2), janë mbështetur në intervista periodike me staf akademik, administrativ e studentë, sikurse edhe në konsultimin e dokumenteve të brendshme.</p> <p>Një tjetër dokument që përmend monitorimin përmes sondazhit, por jo në kohë reale, të aktivitetit akademik e administrativ, është dok. nr. 34 “Perceptimi i studentëve mbi veprimtarinë mësimore 2019-2020”. Ky dokument është hartuar nga Zyra e Statistikës dhe e Vlerësimit të Cilësisë, entitete këto të ndara administrativisht, referuar nenit 5, pika 2 e Rregullores së NjVBC. Në shpjegimin e metodologjisë që përmban ky dokument cilësohet qartë se: “Pyetësorët u shpërndanë në përfundim të secilës lëndë ...”, pra dokumenti nuk sjell referenca për monitorim në kohë reale.</p> <p><i>Rrjedhimisht, për sa më lart, nga pikëpamja dokumentare nuk ka gjurmë dhe nuk mund të konkludohet arsyeshëm e besueshëm mbi frekuencën dhe cilësinë e kontrolleve dhe raportimeve në kohë reale.</i></p>				
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e Internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga inspektimi i prezencës <i>online</i> të këtij institucioni në faqen e tij zyrtare https://www.unizkm.al/study/faculties/en, konstatohet se ky kriter përmbushet. Informacionet janë të publikuara madje në tri gjuhë.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="528 1666 719 1742">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="724 1666 932 1742">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="936 1666 1144 1742">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1149 1666 1366 1742">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

¹⁰⁴ Në takimin me stafin drejtues dhe akademik të institucionit, GVJ e ngriti pyetjen e plotësimit të RVB-së në këtë formë dhe përgjigja iu referua harmonizimit apo vazhdimësisë më të mirë në përmbushjen e kërkesave të standardit. Pra në plotësimin e RVB-së ka mbizotëruar kriteri estetik mbi atë funksional (përmbajtjesor). Për më shumë, shih shënimet e koordinatorit të GVJ në dosjen përkatëse të ASCAL.


Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua dok. nr. 1 dhe dok. nr. 13. Në RVB, për plotësimin e kërkesave të këtij kriteri nuk gjendet asnjë referencë. Po kështu, në dosjen e depozituar në ASCAL nuk përmbahet asnjë dokument financiar (bilanc, pasqyrë të ardhura-shpenzimesh, analiza kosto-të ardhura, raport auditimi, etj), ndonëse raportimi financiar i veprimtarisë është jo vetëm kërkesë specifike e Ligjit 80/2015 (nenet 32, 38, 52), por edhe e vetë Statutit institucional (nenet 10, 33).</p> <p>Në vizitën në terren, GVJ kërkoi specifikisht raporte financiare apo analiza kostosh, për të plotësuar kërkesat e këtij kriteri. Në dokumentacionin shtesë të depozituar në ASCAL më dt. 02.06.2021, të dhënat e kërkuara financiare sërish mungojnë. Në material është përfshirë e njëjta tabelë e referuar në RVB. Kjo tabelë, që i drejtohet Zyrës së Vlerësimit të Cilësisë dhe Kurrikulës, nuk përmban datën, njësinë emetuese, nr. e protokollit dhe as firmën e përgjegjësit për saktësinë e informacionit.</p> <p>Plani financiar i paraqitur në tabelë i referohet të ardhurave dhe shpenzimeve për krejt ciklin 3-vjeçar të studimeve, por disa të dhëna duken të pakuptimta. Fjala vjen, “Shpenzimet për stafin akademik” parashikohen në masën 3.300.000 lekë. Për shkak të moskodifikimit sipas nomenklaturës së shpenzimeve, nuk kuptohet se për çfarë shpenzimesh bëhet fjalë. Gjithashtu nuk kuptohet nëse bëhet fjalë për shpenzim vjetor apo për shpenzim 3-vjeçar, sikurse e citon dokumenti në kokën e tij. Përveç sa më lart, edhe sikur të jenë shpenzime vjetore, vetëm pagat mujore bruto të stafit akademik të angazhuar në program (24 pedagogë të brendshëm dhe 7 të jashtëm sipas dok. nr. 27) e ezaurojnë (me një vlerësim konservator) brenda 2 muajve buxhetin e mësipërm të alokuar. Në këtë këndvështrim, dokumenti i paraqitur ka probleme të theksuara me formën dhe përmbajtjen.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të</p>	<p>Subjekti nuk ka depozituar plan financiar, edhe pas kërkesës eksplicite të GVJ-së gjatë vizitës në terren, rrjedhimisht nuk mund të analizohet dhe konkludohet mbi kërkesat e këtij kriteri.</p>



<p>procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat <i>on-line</i>, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Subjekti nuk ka depozituar raporte auditimi, edhe pas kërkesës eksplicite të GVJ-së gjatë vizitës në terren, rrjedhimisht nuk mund të analizohet dhe konkludohet mbi kërkesat e këtij kriteri.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Subjekti nuk ka depozituar raporte financiare, edhe pas kërkesës eksplicite të GVJ-së gjatë vizitës në terren, rrjedhimisht nuk mund të analizohet dhe konkludohet mbi kërkesat e këtij kriteri.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni nuk ka depozituar informacion financiar, edhe pas kërkesës eksplicite të GVJ-së gjatë vizitës në terren, për të analizuar dhe konkluduar mbi kërkesat e këtij kriteri.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga konsultimi me të gjithë bazën dokumentare të depozituar në ASCAL, konstatohet se janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi: Statuti, pjesa më e madhe e Rregulloreve, Plani Strategjik dhe dokumentet kryesore, shkresore, mbështetëse, si edhe formularët e punës (<i>template</i>) për dizenjimin dhe monitorimin e politikave dhe procedurave.</p> <p>Rregullore dhe dokumente të tjera që mund të kishin lidhje me kërkesat e këtij kriteri, si Kodi i Etikës, Kodi i Disiplinës, Rregullorja e Universitetit, Rregullorja e Fondacionit ZKM, Rregullorja e Bordit të Administrimit, raporte financiare, etj, dokumente këto të cituara në Statut, nuk u konsultuan, për shkak se nuk gjenden në dosjen e e-ASCAL. Gjurmët e zbatimit të këtyre politikave konfirmohen nga vizita në sekretarinë mësimore, sikurse edhe biseda me kampionin e studentëve. Gjithsesi, nga pikëpamja formale, duke iu referuar përputhjes në kohë të dokumenteve, vërehen disa parregullsi. Kështu Statuti i UK ZKM është hartuar në vitin 2018. Në nenin 59, pika 1, citohet se: “<i>Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, strukturat përgjegjëse përgatisin dhe miratojnë çdo rregullore dhe/ose akt tjetër të nevojshëm për menaxhimin e Universitetit, strukturave dhe veprimtarive të tij</i>”. Në dokumentet e depozituara në ASCAL, dok. nr. 48 “Rregullore e provimeve” mban datën 05.04.2017; dok. nr. 54 “Rregullorja e sekretarisë mësimore” mban datën 03.04.2017, dok. nr. 84 “Rregullore për regjistrimin dhe plotësimin e regjistrit bazë” mban datën 03.04.2017; ndërsa për disa rregullore të tjera, siç janë “Rregullorja e bibliotekës”, “Rregullorja e fakultetit”, “Rregullore për kontributet e kërkimit shkencor”, “Rregullore e temës së diplomës”, dhe “Rregullore e NjBSVC” është e pamundur të identifikohet data e miratimit, për shkak se, sikurse shprehur më lart, një pjesë të dokumentacionit i mungon markimi me targën protokollare.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje,</p>	<p>Nga konsultimi me bazën dokumentare konstatohet se vlerësimi në aplikim, pranimi, transferimi, mësimdhënia, testimi i dijeve dhe</p>

<p>garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>diplomimi i studentëve në programin e aplikuar për akreditim kryhet përgjithësisht mbi parimet e mosdiskriminit mbi çdo lloj karakteristike individuale, barazisë dhe të drejtave universale. Kriteri për pranimit dhe diplomim i referohet meritës në arritjet universitare të ciklit paraardhës (pranimit) dhe kryerjes së studimeve (diplomim).</p> <p>Gjithsesi, nga konsultimi me Rregulloren e pranimeve dhe atë të transferimeve (respektivisht dok. nr. 30 dhe 63) citohet se nuk pranohen për regjistrim apo për transferim kandidatë apo studentë që janë regjistruar në programe të tjera studimi, ndërkohë që Ligji dhe aktet e tjera nënligjore nuk e përjashtojnë këtë mundësi për studentët e shkëlqyer. Rrjedhimisht, dokumentet e mësipër-cituar kanë nevojë për amendim në këtë aspekt. Nga konsultimi me Rregulloren e provimeve (dok. nr. 48) vihen re disa procedura inefficente, që në fakt kufizojnë disa të drejta për studentët. Konkretisht, në paragrafin 2.1, fq. 7 e kësaj rregulloreje shkruhet shprehimisht se: <i>“Në rast se studenti regjistrohet dhe më pas nuk paraqitet në provim, pra është në statusin ‘assente’, ai nuk mund të marrë pjesë në provimin e kësaj lënde në apelin (sezonin) pasardhës”</i>. I njëjti rregull vlen edhe për sezonin e provimeve të jashtëzakonshme. Një penaltet i tillë kohor, mund të zëvendësohet me një penaltet monetar për shpenzimet e kryera nga fakulteti për prezencën e munguar të studentit në provim, duke mos iu hequr studentëve të drejtën për të mbaruar në kohë studimet e tyre (disa IAL të tjera e aplikojnë me sukses). Për studentët me status <i>“ritirato”</i>, pra që nuk marrin pjesë në provim, por nënshkruajnë për këtë përpara nisjes së provimit, nuk parashikohen sanksione, ndonëse rezultati i veprimit të tyre është i njëjtë me studentët me status <i>“assente”</i>.</p> <p>Po kështu, në paragrafin 3 <i>“Rregullat e zhvillimit të provimit”</i>, ka disa rregulla që nuk mund të aplikohen mbi të gjithë studentët njësoj, veçanërisht mbi ata me nevoja të veçanta, siç mund të jetë ndalimi kategorik i daljes nga salla për nevoja personale, apo mbajtja vetëm e ujit të pijshëm për t’u konsumuar.</p> <p><i>Duke qenë të vetëdijshëm se në praktikën e UK ZKM këto rregulla në provim janë të relaksuara, sugjerohet rishikimi i tyre edhe në bazën dokumentare.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit¹⁰⁵ krijohet bindja e arsyeshme se kriteret për këtë rubrikë janë në tërësinë e tyre lehtësisht të kuptueshme dhe aksesueshme nga publiku.</p> <p>Gjithsesi, në disa dokumente ka rregulla të paqarta, nëse kryqëzojmë të dhënat midis tyre dhe vizitës në terren. Kështu:</p> <p>a) Në paragrafin 1.3 të Rregullores për provimet, fq. 4, shkruhet se: <i>“Nuk ka të drejtë askush të shtojë emrat me dorë në regjistrin e provimit.”</i> Në paragrafin 2.1.c, fq. 8, të po së njëjtës rregullore</p>

¹⁰⁵ Referuar dok. nr. 1, 13, 21, 41, 48, 30, 61 dhe 64.

<p>lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>shkruhet se: “Në ndryshim nga regjistrat e provimeve të thjeshta, ku emrat regjistrohen automatikisht nga regjistrimi online i bërë nga studenti, këtu (është fjala për regjistrin e provimit të përbërë, pra kombinim shkrim-verbal) emrat shënohen me dorë nga pedagogu.”</p> <p>Është e paqartë se cili rregull prevalon mbi tjetrin dhe, për aq kohë sa provimi i kombinuar përfshin dhe provimin me shkrim, nuk kuptohet qartë se për cilin provim bëhet shënimi me dorë nga pedagogu.</p> <p>b) Në paragrafin 2.2.c, fq. 9, të rregullores së provimeve shkruhet se: “Përpara fillimit të provës me shkrim, Komisioni i provimit i komunikon studentëve dhe Sekretarisë Mësimore nëse prova me gojë është e detyrueshme ose jo”. Në paragrafin 1.4 (mënyra e zhvillimit të provimit), fq. 4, shkruhet se: “Mënyra e zhvillimit të provimit dhe mënyra e vlerësimit të studentëve përcaktohen nga pedagogu përgjegjës i lëndës, i cili ia komunikon studentëve përpara përfundimit të veprimtarisë mësimore në lëndën e tij...” Është sërish e paqartë se kur iu komunikohet studentëve mënyra e testimit të dijeve. Po t’i shtosh kësaj edhe faktin që gjatë vizitës në terren GVJ pyeti specifikisht stafin akademik se si ndahej vlerësimi midis provimit me shkrim dhe atij me gojë, përgjigjja ishte që provimi me shkrim është kualifikues për provimin me gojë, pra nuk janë dy provime të ndara, por vazhdim i njëri-tjetrit.</p> <p>c) Rregullorja e provimeve nuk parashikon procedurë për studentët që duan të përmirësojnë notën e tyre në një lëndë. Pra në të nuk del qartë nëse procedurat e përshkruara vlejné për provimin për herë të parë apo për riprovime.</p> <p>d) Rregullorja e provimeve nuk përmban informacion financiar për pagesat në rastin e ridhënies së provimeve. Ky informacion nuk gjendet as në dokumentet e tjera të depozituara.</p> <p>Nga konsultimi me faqen online të subjektit, https://www.unizkm.al/categories/kandidate-shqiptare/posts/en përmbahet informacion për pranimet dhe transferimin e studimeve për të interesuarit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Referuar dok. nr. 61 (kriteret e pranimet) konstatohet se kërkesat e këtij kriteri përmbushen plotësisht. Dokumenti mban datën 11.02.2019, që përkon me periudhën kur depozitohen edhe kriteret për vitin e ardhshëm akademik në MASR.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të</p>	<p>Referuar dok. nr. 61, Statutit institucional dhe kryqëzimit me kërkesat e Ligjit 80/2015 dhe aktet nënligjore (Udhëzimet e Ministrit) për pranimin, regjistrimin, transferimin, etj, të studentëve vendas dhe të huaj, konstatohet përmbushja e plotë e kërkesave të këtij kriteri.</p>

ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.									
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Pas konsultimit me dok. nr. 68 "Politikat e marketingut për programin", vizitës në rrjetet sociale dhe prezencën në WEB, konkludohet se institucioni bën marketing të produkteve të tij lidhur me këtë program studimi, duke udhëzuar në mënyrë të detajuar publikun. Vazhdimisht UK ZKM është pjesë e vizitave në shkollat e mesme, si edhe e panairove "Work and Study" apo panairove të organizuara nga MASR dhe të tjerë.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Nga dokumentet e konsultuara, rëndësi të veçantë për kërkesat e këtij kriteri, përmendur njëkohësisht edhe si referencë në RVB, është dok. nr. 18 "Rregullore e programit të studimit në Bachelor në 'Ekonomi Ndërmarrje'". Ky dokument, sikurse theksuar më lart, nuk është rregullore, por një përmbledhje e shkurtër e objektivit të programit, profilit që ai ndërton tek studentët dhe mundësitë e punësimit pas diplomimit. Dokumentit i mungojnë referencat ligjore dhe targa protokollare.</p> <p>Nga të gjitha rregulloret e konsultuara është e pamundur të nxirret informacion për kriteret e avancimit të studentëve nga njëri vit në tjetrin. Rregullorja e provimeve përmban informacion për pragun kalues në testimin e një lënde, por jo për numrin minimal të krediteve që duhet të sigurojë një student për të avancuar në vitin pasardhës.</p> <p>Në rregulloren e temës së diplomës, në nenin 5 të saj, specifikohet kushti që për të hyrë në provimin e diplomës, studenti duhet t'i ketë marrë të gjitha kreditet që specifikon programi i studimit.</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Referuar dok. nr. 30 "Rregullore e UK ZKM për transferimet", konstatohet në faqen 3 të saj se, për programin e studimit "Ekonomi Ndërmarrjeje", Komisioni Didaktik <i>ad hoc</i> , i ngritur për vlerësimin e studimeve universitare të kryera më parë, i jep një peshë prej 50% këtyre studimeve në pranimin e kandidatit potencial për transferim. Po kështu respektohet pragu minimal i përcaktuar nga MASR për transferimet, ai i zotërimit të të paktën të 30 krediteve në programin e studimit ku

	aplikohet për transferim. Referuar pranimeve, UK ZKM, përveç kriterëve të përcaktuara me VKM, bën publike edhe kriterin për njohjen e gjuhës italiane si parakusht për të ndjekur studimet pranë kësaj IAL-je.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në lidhje me këtë kriter, GVJ konsultoi dok. nr. 21 "Syllabuset e lëndëve" dhe rregulloret e provimeve, të diplomimit dhe të fakultetit. Në rregullore specifikohen pragjet minimale e maksimale të vlerësimit për çdo lëndë, sikurse edhe kriteri i frekuentimit të detyrueshëm. Po kështu, për temën e diplomës jepet edhe procedura e ponderimit të vlerësimit final. Sa i përket kriterëve e procedurave të vlerësimit në lëndë të veçanta, GVJ u mundua t'i gjejë këto informacione në syllabuset e lëndëve, por pa sukses. Në asnjë syllabus nuk jepet sistemi i vlerësimit, ndarë si përqindje e notës përfundimtare, në përputhje me sa parashihet në VKM nr. 41, dt. 24.01.2018.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Referuar dok. nr. 41 dhe 49, konstatohet se ekzistojnë rregullat për punimin e diplomës dhe mbrojtjen e saj, sikurse edhe letrat (formularët) e punës për këtë qëllim. Një rregull që mungon në këtë rregullore ka të bëjë me kërkesat anti-plagjiaturë dhe masat që merren në rast shkeljesh. <i>Rregullorja mund të pasurohet edhe më tej për kërkesat mbi mënyrën e citimit të referencave, metodologjisë së përdorur, listimit të grafikëve, tabelave, etj., për t'i dhënë asaj karakterin e një manuali ndihmës për studentin.</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në hartimin e RVB-së, grupi i ekspertëve të brendshëm i është referuar dok. nr. 74-81, në fq. 59 të tij. Këto dokumente nuk gjenden në dosjen e depozituar në e-ASCAL. Ka një hendek në dokumentacionin e ngarkuar, midis dok. nr. 72 dhe atij nr. 82. Dokumentet përmidis mungojnë. Nga linqet e përmbajtura për këto dokumente në RVB, nuk mund të aksesohet asnjë, për shkak se dokumenti është ngarkuar i skanuar dhe jo në format origjinal <i>pdf</i> . Gjithsesi, nga bisedat me studentët, ata u shprehën se informohen vazhdimisht, sa herë kanë nevojë, për programin e studimit dhe aktivitetet e lidhra me të.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën,	Referuar dok. nr. 18, vizitës inspektuese në terren dhe prezencës <i>online</i> të subjektit, konstatohet se ekziston mundësia që studentët të informohen paraprakisht mbi kërkesat e këtij kriteri. Për çdo

organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	informacion shtesë, programi i studimit ka edhe një koordinatore që, në bazë të dok. nr. 35, ka në përshkrimin e saj të punës, specifikisht informimin e studentëve mbi aspekte të ndryshme të programit dhe procesit mësimor.			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga konsultimi me dok. nr. 21, që përmban syllabuset e lëndëve të programit, konstatohet se mungojnë disa të dhëna. Siç është përmendur edhe më lart, në syllabuset e vënë në dispozicion të GVJ, nuk përmbahen të gjithë pedagogët që deklarohen se janë të angazhuar pranë këtij programi studimi. Mungon sistemi i detajuar i vlerësimit, për t'u njohur paraprakisht me peshën e çdo forme të vijueshme testimi në vlerësimin final. Në disa syllabuse që i referohen aktualitetit shqiptar, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar është e huaj, pa referenca ndaj Shqipërisë. Ka raste kur një lëndë citohet "e detyrueshme" në një dokument, por është "me zgjedhje" në dokumente të tjerë. ¹⁰⁶			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Për plotësimin e kërkesave të këtij kriteri, GVJ iu referua Raportit të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, depozituar në ASCAL, pas vizitës në terren, sikurse edhe takimit me studentët e programit. Rezulton se studentët informohen si pranë kësaj zyre, ashtu edhe nga stafi akademik për mundësitë e punësimit dhe avancimit në karrierën akademike e atë profesionale.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Referuar infrastrukturës së inspektuar në terren, takimit me studentë dhe personelit administrativ, rezulton se studentët kanë të gjithë aksesin e nevojshëm në informacion për të vjelë efektshëm frytet e shërbimeve që ofron UK ZKM.			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga takimi me stafin dhe studentët, u konstatua se, edhe për shkak të pandemisë, informacioni ishte lehtësisht i disponueshëm edhe në distancë, sikurse i gjurmueshëm nga të gjitha strukturat menaxheriale të përfshira (pedagogët për mësimdhënien dhe sekretaria e administrata për regjistrimin dhe raportimin)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë,

¹⁰⁶ Shih dhe krahaso lëndën "Kontabiliteti i kostos" në dok. nr. 21 me të dhënat për këtë lëndë në dok. nr. 17 & 18.

nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Meqënëse GVJ kishte në fokus vetëm një program studimi, del përtej objektit të ri-akreditimit shprehja e GVJ-së për çdo program studimi që ofron institucioni.</p> <p>Sa i përket programit Bsc në “Ekonomi ndërmarrjeje”, nga dokumentet e vëna në dispozicion, ato që lidhen deri diku me kërkesat e këtij kriteri janë: dok. nr. 19 “Raport mbi të diplomuarit e programit të studimit”, dok. nr. 34 “Sondazh mbi veprimtarinë mësimore”, dhe tri dokumentet e fundit të depozituara: 1. “Analiza e tregut të punës”, 2. “Analiza e NjSBVC” dhe 3. “Raporti i Zyrës së Këshillimit të Karrierës”. Disa nga këto dokumente sillen si referenca edhe në RVB.</p> <p>Nga sondazhi i veprimtarisë mësimore për vitin akademik 2019-2020 konstatohet se bëhet fjalë për statistika mbi vlerësimin që studentët kanë për aspekte të ndryshme të procesit mësimor, por jo për statistika për numrin e studentëve apo karakteristika të ndryshme të tyre (nota mesatare, qyteti nga vjen, kalueshmëria ndër vite, etj.)</p> <p>Raporti i të diplomuarve në program dhe analiza e tregut të punës, përmbajnë të dyja informacione të përgjithshme dhe një statistikë të vetme për numrin e të diplomuarve (155 studentë) pa specifikuar se për cilin vit bëhet fjalë. Të dyja dokumentet nuk përmbajnë të dhënat protokollare për të nxjerrë indirekt ndonjë referencë kohore.</p> <p>Analiza e NjSBVC dhe Raporti i Zyrës së Këshillimit të Karrierës janë hartuar të dyja në rang Universiteti. Në ato pak të dhëna që gjenden për programin e studimit në fokus, statistikat janë vetëm për një vit akademik (2017-2018 për raportin e NjVSBC dhe 2020-2021 për raportin e Zyrës së karrierës). Nga mënyra se si institucioni ka depozituar të dhënat, nuk mund të krijohet perceptim konkludues se si mbahen statistikat vjetore. Nga vizita në terren, inspektimi i regjistrave me zgjedhje për studentët konfirmon mbajtjen e rregullt dhe korrekte të informacioneve individuale për ta, por jo të përmbledhur në format sintetik statistikor.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga vizita në terren konfirmohet mbajtja e saktë në regjistrin themeltar e të dhënave të tilla, individuale, për çdo student. Në dokumentet e depozituara nuk gjenden të dhëna statistikore vjetore në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri. Statistikat e dhëna në dokumentet e cituara në kriterin e mësipërm, nuk janë të dizenuara për këtë qëllim.</p> <p>Referuar dok nr. 27. Tabela përmbledhese, tabela nr 21, numri i studentëve për një cikël studimi është:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 22 studentë; Për vitin akademik 2019-2020 28 studentë; Për vitin akademik 2020-2021 22 studentë;</p>

Totali për një cikël studimi 72 studentë				
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Nga inspektimi i regjistrit të notave dhe regjistrit të studentëve rezulton se institucioni mban të dhëna të përhershme, në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga dokumentet e depozituara në ASCAL, nuk disponohet informacion për kërkesat e këtij kriteri. Në RVB është sjellë si referencë sërish dok. nr. 34 "Perceptimi i studentëve mbi veprimtarinë mësimore", por ky sondazh nuk ka lidhje me sa kërkon ky kriter. Nga vizita në terren, GVJ konsultoi regjistrat fizikë të mbajtjes së informacionit për studentët, por jo ato elektronikë. Nga pyetjet drejtuar Sekretarisë Mësimore pohohet se i njëjti informacion fizik, dublohet menjëherë elektronikisht, në mënyrë të sigurtë dhe konfidenciale.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nga dokumentet e depozituara, nuk gjenden informacione të tilla, të detajuara në këtë drejtim. Informacionet përgjithësisht janë në rang universiteti dhe statistikave e prezantuara nuk fokusojnë kërkesat e këtij kriteri për programin e studimit në fokus ri-akreditimi. <i>Sugjerohet hartimi, publikimi dhe rishikimi periodik i të dhënave dhe raporteve të tilla, me qëllim matjen e performancës së studentëve dhe treguesve të tjerë të stafit akademik, për të përmirësuar indikatorët e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Referuar dokumenteve ¹⁰⁷ konstatohet se kërkesat e këtij kriteri përmbushen përmes: a) Parashikimit në Statut për zgjedhjen dhe angazhimin e studentëve, përkatësisht në: 1. Nenin 12, pika 2, germa "d"; 2. Nenin 26, germa "e", dhe; 3. Nenin 44; b) Parashikimit në Rregulloren e Fakultetit, konkretisht: Neni 8, germa "e"; c) Parashikimit në Rregulloren për zgjedhjen e studentëve në struktura, përgjatë gjithë dokumentit;

¹⁰⁷ Për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri, GVJ konsultoi dok. nr. 1, 13, 15, 85, 87 dhe 88.

	<p>d) Parashikimit në Rregulloren e NjBSVC, konkretisht: Neni 3, pika 1, germa “d”;</p> <p>Në dokumentet e mësipërme parashikohet në mënyrë shterruese, në formë dhe në përmbajtje, përfshirja e studentëve në organet vendim-marrëse e këshilluese.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, për shkak se përfshirja e studentëve në organe vendim-marrëse e këshilluese është pothuajse gjithnjë në kuadrin e një grupi pune, është e vështirë të identifikohet kontributi specifik i palës studentore. Dokumentet e konsultuara nuk parashikojnë produkte specifike nga studentët në këtë drejtim dhe as nuk janë ngarkuar në ASCAL sugjerime apo rekomandime që studentët kanë dhënë dhe si janë implementuar më pas ato.</p> <p>Gjithsesi, nga takimi me studentët gjatë vizitës inspektuese në terren, studentët u shprehën të kënaqur me dëgjimin e zërit të tyre për çështje të ndryshme, akademike e administrative, të mbarëvajtjes në fakultet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga konsultimi me bazën dokumentare, si edhe intervistat me stafin pedagogjik dhe studentët, ngarkesa e parashikuar mësimore për studentët konsiderohet e pranueshme. Sikurse theksuar më lart, shpërndarja e ngarkesës kishte qenë i vetmi rekomandim nga akreditimi i mëparshëm dhe kjo çështje është prekur sërish në RVJ - në për këtë ri-akreditim. Ndonëse nuk është reflektuar në syllabuse, ku lëndët që lëvrojnë pedagogët italianë shfaqen vetëm me një pedagog, nga intervista me stafin akademik pohohet se për këto lëndë, ka edhe një pedagog tjetër që lehtëson shpërndarjen normale të ngarkesës. Po kështu, duke iu referuar rregulloreve për provimet, transferimet dhe mbrojtjen e diplomës, konstatohet se procedurat respektive janë joburokratike dhe të balancuara midis angazhimit që kërkojnë dhe produktit që gjenerojnë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga konsultimi me Statutin institucional, Rregulloren e fakultetit dhe Rregulloren e NjBSVC, ku studentët janë pjesë e organeve drejtuese në rang universiteti dhe njësie kryesore, konstatohet se detyrat që parashtrihen për këto organe vendim-marrëse, përfshijnë hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit.</p> <p>Këto dokumente parashikojnë mbledhje periodike (2 herë në vit minimalisht për Senatit akademik, 4 herë në vit minimalisht për NjBSVC dhe 2 herë në vit minimalisht për Këshillin studentor) që nënkupton mundësinë mbi baza të rregullta për studentët që të shprehen lidhur me kërkesat e këtij kriteri. Gjithsesi, në ASCAL nuk janë depozituar minuta apo procesverbale mbledhjesh, për të ilustruar pjesëmarrjen konkrete në këtë drejtim nga ana e studentëve, si edhe ndryshimet e ndërmarra më pas në refleksion ose jo të këtyre sugjerimeve studentore.</p>


<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në dy raportet didaktike¹⁰⁸ të hartuara nga Koordinatori i programit dhe Dekani, nuk gjenden gjurmë të perspektivës studentore për procesin mësimor (përfshirë edhe procesin e vlerësimit si pikë kyçe të procesit mësimor), perspektiva këto që do t'i shtonin vlerë këtyre dy dokumenteve dhe do t'i bënin ato të aksesueshme edhe për studentët e programit. Mbështetur në Rregulloren e fakultetit, në përputhje me nenin 11, germa “g”, Koordinatori i programit të studimit e ka detyrë funksionale përcjelljen e mendimit të studentëve për performancën e programit të studimit tek Dekani.</p> <p>Në dok. nr. 34, që përmban të dhëna statistikore për sondazhe të kryera me studentët në vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020, cilësohet në paragrafin 3 “Aspekte metodologjike”, fq. 3, se pyetësorët u shpërndanë përpara sezonit të provimeve. Po kështu, në pyetësorin tip të përfshirë në dokument, nuk përmbahen pyetje që adresojnë kërkesat e këtij kriteri për provimet e pjesshme apo format e tjera të kontrollit të dijeve përgjatë vitit, përpara provimit përfundimtar në sezon. Rrjedhimisht, ky dokument nuk përmban të dhëna për kërkesat e këtij kriteri.</p> <p>I vetmi dokument që parashikon procesin e ankimimit dhe mundësinë e rishikimit të provimit e reflektimit institucional është ai me nr. 48 “Rregullorja e provimeve”. Paragrafi 1.6, fq. 6 e këtij dokumenti shtjellon procedurën ankimese. Në përgjithësi procedura është korrekte dhe parashikon hapat e nevojshëm për trajtimin e ankesës. Autoriteti që gjykon dhe merr vendim të formës së prerë për mënyrën e trajtimit të ankesës është Dekani. Duke qenë se vetë Dekani, referuar dok. nr. 21 (syllabuset) është titullar i një lënde (“E drejtë publike”) mbetet për t’u zgjidhur dhe reflektuar në rregullore se si duhen trajtuar ankesat në këtë lëndë, për të shmangur konfliktin e interesit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e</p>	<p>Në bazë të Ligjit 80/2015, krijimi i strukturave studentore për IAL-të jopublike parashihet në statutin institucional. Nga konsultimi me këtë statut, konstatohet se nenet 44, 45 dhe 46 shprehen për krijimin e</p>

¹⁰⁸ Për vlerësimin e kërkesave të këtij kriteri, GVJ konsultoi dok. nr. 1, 26, 31, 34, 48 dhe “Raportin vjetor të NjBSVC”.



shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Këshillave studentorë, Zyrën e këshillimit të karrierës, si edhe Garantuesit studentor, respektivisht. Nga dokumentacioni i depozituar në ASCAL, procedurat për shërbim dhe informim të studentëve konstatohen në dok. nr. 15, 30, 39, 40, 48, 49, 54, 66 dhe 85 që tjerri përmbajtjen e rregulloreve të ndryshme, bibliotekës, sekretarisë, etj. Funksionon gjithashtu edhe koordinatori i programit, detyrat e së cilës janë ekskluzivisht të parashikuara për plotësimin e kërkesave të këtij kriteri. Nga inspektimi në terren, mjediset e bibliotekës, laboratorit, mensës, sekretarisë dhe asistencës logjistike me akses në Internet, fotokopje, etj, ishin tërësisht funksionale.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Neni 11 i Rregullores së Fakultetit specifikon në mënyrë eksplicite dhe shterruese detyrat e koordinorit të programit, në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri. Neni 45 i Statutit institucional prek në vija të trasha detyrat e Zyrës së karrierës. Nga dokumentacioni i depozituar në ASCAL nuk u gjetën rregullore apo manuale pune për këto dy funksione, në detajim të detyrave që parashtron për to Statuti dhe Rregullorja. Gjithsesi, të dyja strukturat e mësipërme kanë depozituar nga një raport (dok. nr. 26 për Koordinatorin dhe dok. i depozituar pas vizitës në terren për Këshillimin e karrierës), duke dëshmuar për zbatimin me sukses të kërkesave të këtij kriteri.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Për vlerësimin e kërkesave të këtij kriteri, GVJ konsultoi raportin e Zyrës së karrierës me dt. 17.09.2020. Dokumenti përfaqëson një raportim për vitin akademik 2019-2020 tek Rektori i UK ZKM nga drejtuesja e kësaj zyre. Raportimi është në rang IAL-je dhe përmban një të dhënë për 4 studentë të degës ekonomi, që kanë studiuar për periudhën shkurt-qershor në Universitetin Ekonomik të Krakovës (Poloni), në kuadrin e një marrëveshjeje bashkëpunimi për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve. Dokumenti i dytë, depozituar nga kjo Zyrë, mban datën 03.03.2021 dhe mbulon periudhën janar-mars 2021. Në këtë dokument jepen të dhëna mbi funksionet e kësaj zyre, lidhjet e saj me tregun dhe numrin e studentëve të asistuar për punësim. Nga dy dokumentet e mësipërme, sikurse edhe nga biseda me studentët, konstatohet përmbushje optimale e kërkesave të këtij kriteri.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Referuar dy dokumenteve të cituara në kriterin më sipër, nuk jepen të dhëna për ndjekjen që Zyra e karrierës i bën studentëve pas diplomimit. Në paragrafin 1.5 të raportit që kjo zyrë ka përgatitur më dt. 03.03.2021 citohet se baza e të dhënave për post-diplomantët përditësohet përmes rrjeteve sociale dhe një pyetësori në format <i>Google Questionnaire</i> . Pyetësori përmbahet në linkun https://www.unizkm.al/posts/slug/mbetemi-ne-kontakt/en , por kur klikohet mbi të, ai nuk është i disponueshëm. Referuar dok. nr. 19 "Raport mbi të diplomuarit në program", përgatitur nga kjo zyrë, konstatohet se dokumenti nuk përmban të dhëna protokollare, pra nuk

	mund të konkludohet se kujt i përcillet ai. Sa i përket përmbajtjes, raporti jep një statistikë pa referencë kohore për numrin e të diplomuarve në këtë program (155), nr. e studentëve që janë mundur të kontaktohen (145) dhe numrin e atyre që janë punësuar (137). Lidhur me cilësinë e punësimit, raporti shprehet se të gjithë të punësuarit punojnë në profesionin e tyre, pa dhënë detaje të mëtejshme në këtë drejtim. <i>GVJ rekomandon që raportet e përgatitura mund të jenë më të plota dhe të detajuara, për të nxjerrë konkluzione e rekomandime të vlefshme, në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar Ligjit 80/2015 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, sikurse Statutit të UK ZKM dhe Rregulloreve që e detajojnë atë dhe të depozituara në e-ASCAL konstatohet se: a) Statuti, në nenin 10, pika 3 e tij, angazhohet që të gjitha organet dhe strukturat universitare operojnë në mënyrë që të sigurohet cilësia e shërbimeve të ofruara, në përputhje me standardet europiane; b) Statuti, në nenin 13, pika 1, germa "1" ngarkon Senatit Akademik si strukturën përgjegjëse për garantimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet universitare, në përputhje kjo me nenin 38, pika 1, germa "j". c) Statuti, në nenin 21, pika 1, germa "c" dhe në pikën 2 të po të njëjtit nen, shprehet për ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel njësie kryesore, në përputhje me parashikimet e nenit 46, pikat 1 & 2 të Ligjit 80/2015. Ky komision, në bashkëpunim me NjSBC, ka përgjegjësinë e hartimit dhe implementimit të politikave institucionale lidhur me sigurimin e standardeve të cilësisë;

	<p>d) Statuti, në nenin 22, parashikon ngritjen dhe funksionet e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</p> <p>e) Rregullorja e NjSBC, që parashtron një sërë detyrash për këtë njësi, përfshin si struktura suportuese për garantimin e cilësisë edhe Zyrën e Vlerësimit të Cilësisë dhe Kurrikulave, Zyrën e Statistikës dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës, në nenin 5, pika 2 të saj;</p> <p>Në dokumentacionin e depozituar në ASCAL nuk gjenden të dhëna për Komisionin e Përhershëm të Cilësisë (për secilin nivel). Ky komision nuk përmendet as në rregulloren e NjSBVC, ku sipas germës “c” më lart, ka detyrimin e bashkëpunimit për hartimin dhe implementimin e politikave lidhur me cilësinë. Gjithashtu, në dokumentacion nuk gjenden dokumente të politikës lidhur specifikisht me cilësinë, arritjet dhe mosarritjet e kaluara, objektivat për të ardhmen dhe planet për t’i realizuar ato. Nga konsultimi me dok. nr. 10 “Analiza SWOT e programit”, konstatohet vetëm një pikë e fortë lidhur me cilësinë (standardet e programit të studimit në nivel evropian), ndërsa nga konsultimi me dok. nr. 16 “Plani i zhvillimit institucional 2017-2027”, për programin e studimit në fokus është formuluar vetëm një objektivi jo i detyrueshëm (ofrimi i programit në gjuhën angleze). Për sa më lart, GVJ, edhe pas vizitës në terren, krijon bindjen e arsyeshme se cilësia është një komponent që merret si i mirëqenë për strukturat drejtuese dhe ekzekutuese të fakultetit që ofron programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nga konsultimi me bazën dokumentare dhe vizita në terren, konstatohet se ekziston NJSBVC. Përbërja e kësaj njësie është konstituuar me Dekretin nr. 47 të Rektorit të UK ZKM, që mban datën 26.09.2019 dhe nr. prot. 414. Kjo njësi ka në përbërje të saj 3 profesorë nga fakultetet e shkencave mjekësore dhe farmaceutike, një ekspert të jashtëm dhe një përfaqësues të studentëve.</p> <p>Sa i përket funksionalitetit të kësaj njësie, në dokumentacionin fillestar të depozituar në ASCAL nuk përmbahej asnjë raport i gjeneruar prej saj. Në RVB është referuar një raport i Zyrës së Statistikës (dok. nr. 34), që sipas Rregullores së NjSBVC mbështet këtë njësi në funksionimin e saj. Ky raport, nga pikëpamja e formës, nuk është raport i firmosur nga përfaqësuesit e NjSBVC, por vetëm nga drejtuesi i Zyrës së Statistikës, që nuk është pjesë përbërëse e NjSBVC. Nga pikëpamja e përmbajtjes, raporti shpreh vetëm gjetjet statistikore për pyetësorët e dërguar studentëve, por nuk përmban asnjë analizë, konkluzion apo rekomandim për përmirësimin e cilësisë, në cilindo dimension të saj. Në vizitën e tyre në terren, anëtarët e GVJ-së kërkuan specifikisht raportet vjetore të cilësisë, gjeneruar nga NjSBVC në përputhje me nenin 22, germa “b” të Statutit dhe nenin 2, germa “b” të Rregullores së NjSBVC, të paktën për 3 vitet e fundit akademike. Në përgjigje të</p>

	<p>kërkesës së GVJ, institucioni depozitoi pas vizitës vetëm një raport të kësaj njësie, që mban datën 20.11.2018 dhe i referohet të dhënave për vitet akademike 2016-2017 (pjesërisht për 8 indikatorë) dhe 2017-2018 (pjesërisht për 3 indikatorë të tjerë). Nga biseda me anëtarët aktualë të kësaj njësie dhe përfaqësuesin e Zyrës së Statistikës, pohohet se nuk ka raporte cilësie për vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020. Në këto vite, edhe për shkak të pandemisë, institucioni duhet të ishte përshtatur dhe të kishte krijuar e shpërndarë një model (sëbashku me indikatorët përkatës të performancës) për garantimin e cilësisë, si një sfidë ndaj përdorimit intensiv të teknologjisë në mësim-dhënie e mësim-nxënie. Sa i përket strategjisë institucionale për përmirësimin e cilësisë, në dokumentacionin e depozituar nuk gjende gjurmë të një dokumenti të tillë. Edhe në raportin e vetëm të cilësisë, depozituar në e-ASCAL, si dokumente referuese për hartimin e dokumentit përmenden: a) Rregullorja e NjBSVC; b) Ligji 80/2015, dhe; c) Statuti institucional.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Nga konsultimi me dok. nr. 34 dhe raportin e NjBSVC, konstatohet se institucioni përdor në nivel operacional:</p> <p>a) <i>pyetësorët tek studentët</i> për mbledhjen e të dhënave lidhur me aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, në përputhje kjo me pikat 3 & 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015;</p> <p>b) në raportin e NjBSVC, pjesa metodologjike referon kryerjen e <i>intervistave me stafin akademik e administrativ</i> për vjeljen e mendimeve të tyre lidhur me cilësinë;</p> <p>c) gjithashtu, po në raport përmenden <i>studimet e dokumentacionit dhe mbledhjet me struktura të ndryshme</i>, të gjitha këto instrumente të vlefshme për mbledhjen e të dhënave lidhur me cilësinë. Raporti në tërësinë e vet ka një qasje narrative, përshkruese, më tepër sesa problemore, për të identifikuar mangësitë në cilësi dhe ndërmarrë veprimet e duhura për t'i korriguar ato;</p> <p>Nga pikëpamja operationale, GVJ nuk gjeti gjurmë të monitorimit në kohë reale të cilësisë, por vetëm monitorim <i>ex-post</i>.</p> <p>Në aspektin taktik, institucioni përdor:</p> <p>a) <i>raportime tek drejtuesit</i>;</p> <p>b) <i>masa penalizuese dhe përshkallëzuese</i> për shkelje të ndryshme;</p> <p>Sa i përket raportimeve, një pjesë e dokumentacionit duhet përmirësuar nga pikëpamja protokollare.</p> <p>Në aspektin strategjik:</p> <p>a) <i>akreditimin e jashtëm</i>. Sigurimi i jashtëm i cilësisë për këtë program akreditimi është realizuar përpara 6 vjetësh dhe mban datën 16.09.2015. Ky akreditim ka lënë vetëm një rekomandim.</p>



	Sa i përket aspektit strategjik, NjSBVC duhet të gjenerojë informacion më sasior dhe cilësor, për t'i ardhur realisht në ndihmë GVJ për akreditim të jashtëm, në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 në këtë aspekt.			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Sikurse theksuar vazhdimisht më lart, nuk gjendet një politikë e qartë për cilësinë. Periudiciteti i ndjekjes së procedurave nuk mund të konfirmohet, për aq kohë sa nuk janë depozituar raportet vjetore për cilësinë, edhe pas kërkesës eksplicite të GVJ-së. Sa i përket kulturës lidhur me cilësinë, <i>GVJ i qëndron mendimit se cilësia është një atribut që merret i mirëqenë në krejt hierarkinë institucionale të strukturave që ofrojnë programin e studimit, por që nuk arritën ta provojnë me dokumentacion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Programi i studimit në fokus ofrohet nga 3 njësi bazë të Fakultetit të Shkencave Politike, Ekonomike e Sociale të UK ZKM. Të trija këto njësi, në bazë të rregullores së fakultetit, kanë përgjegjësi të parashikuara në nenin 3, pika 4 të kësaj rregulloreje, përgjegjësi që lidhen kryesisht me propozimin ose dhënien e mendimeve lidhur me programin. Është Dekani që, në bazë të kësaj rregulloreje, ka atributet vendim-marrëse dhe ekzekutuese kryesore lidhur me mbarëvajtjen e programit në aspektet e ndryshme menaxheriale që parashikon ky kriter. Disa detyra administrative i janë caktuar edhe Koordinatorit të programit. Sa i përket cilësisë, është NjSBVC që ka detyra lidhur me monitorimin dhe rishikimin e këtij programi, por kjo njësi funksionon në rang Universiteti dhe jo Njësie kryesore. Komisioni i përhershëm i cilësisë, që në Statut specifikohet se ngrihet edhe në rang Fakulteti, nuk ka gjeneruar të dhëna në dokumentacionin e depozituar në ASCAL. <i>Sugjerohet që institucioni të bëjë funksionale Komisionin e përhershëm të cilësisë, në zbatim të parashikimeve statutore.</i>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe	Nga raportet e depozituara prej strukturave të përmendura më sipër, konstatohet se:

<p>mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>a) Në raportet e Dekanit dhe Koordinatorit për aktivitetin didaktik nuk përmbahen informacione konkrete për programin e studimit;</p> <p>b) Në raportin e Zyrës së statistikës, që mbështet NjSBVC në funksionimin e saj, prezantohet pyetësi për studentët që, përmes pyetjeve që lidhet me programin e studimit në fjalë, adreson aspektin mbikqyrës që kërkon ky kriter;</p> <p>c) Në raportin e depozituar nga NjSBVC nuk përmbahen të dhëna lidhur me mbikëqyrjen e këtij programi studimi, sa i përket cilësisë së kurrikulës së ofruar, lidhjes së saj me tregun e punës, etj;</p> <p>d) Syllabuset e depozituara në ASCAL përmbajnë vulën e institucionit dhe firmën e koordinatorës së programit, ndërkohë që është Rektori ai që miraton programet e studimit;</p> <p>Për sa më lart, duke mos disponuar raporte ndër vite të NjSBVC dhe Zyrës së statistikës, është e pamundur të konfirmohet karakteri i herëpashershëm i aktiviteteve shqyrtuese, miratuese dhe mbikëqyrëse në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri.</p> <p><i>Sugjerohet përgatitja vjetore, periodike e raporteve të cilësisë, që të adresojnë kujdesshëm kërkesat e këtij kriteri.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga dy raportet e depozituara dhe të cituara në kriteret e mësipërme, ai i Zyrës së Statistikës detajon në njëfarë mase metodologjinë e përdorur për të vjelë dhe analizuar përgjigjet e studentëve në pyetësorët respektivë. Dokumenti ka përdorur mesataren për të bërë krahasime nga viti në vit dhe midis një programi studimi dhe universitetit në tërësi. Ky sondazh e ka nxjerrë perceptimin e studentëve për këtë program “Më pak sesa mirë” (5,7 nga 7), sikurse mund të konstatohet në fq. 15 të materialit.</p> <p>Në raportin e NjSBVC janë përdorur indikatorë për performancën e studentëve në rang universiteti, përfshirë edhe ata në programin e studimit subjekt ri-akreditimi, por nuk sqarohet metodologjia në aneksin përkatës të saj. Për shkak se mungojnë raportet ndër vite është e pamundur të konkludohet për stabilitetin e metodologjisë dhe aplikimin e saj rigoroz vit pas viti, sikurse e kërkojnë aktet rregullatore.</p> <p><i>Sugjerohet prezantimi rigoroz i metodologjisë vlerësuese në raportet e cilësisë së NJSBVC, sikurse edhe aplikimi i metodave që kryqëzojnë të dhënat për t’u bindur për vërtetësinë e tyre.</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendim-marrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sikurse cituar më lart, një pjesë të mirë të dokumentacionit të UK ZKM, depozituar në ASCAL, i mungojnë të dhënat protokollare. Të dy dokumentet e vlerësimeve, që përmenden në kriterin më lart, nuk përmbajnë strukturën së cilës i drejtohet raporti dhe as numrin e protokollit. Rrjedhimisht, nuk mund të konkludohet për kërkesat e këtij kriteri. Edhe në raportet e Dekanit e Koordinatorës nuk gjenden referenca ndaj këtyre raporteve, për të konkluduar indirekt se këto</p>

	dokumente janë konsultuar prej tyre. Në prezencën <i>online</i> të subjektit nuk gjenden të publikuara raporte të tilla ndër vite. <i>Sugjerohet që dokumentet e depozituara dhe të vëna në dispozicion të vlerësuesve të jashtëm të cilësisë, të jenë të gjitha të sigluara nga palët që kanë kaluar raportin në verifikim, të përmbajnë të dhënat e plota protokollare dhe të ketë gjurmë të shënimeve të lëna për zbatim nga strukturat drejtuese.</i>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet vlerësuese, të cituara nuk përmbajnë analiza, konkluzione të detajuara dhe rekomandime konkrete për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e situatës. <i>Sugjerohet që çdo raport të shoqërohet me rubrikat e konkluzioneve, rekomandimeve dhe planet e veprimeve të miratuara, me objektiva SMART për përmirësimin e situatës, përmes adresimit të mangësive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Sikurse theksuar më lart, institucioni depozitoi vetëm një raport të NjSBVC, pavarësisht kërkesës së GVJ për të paktën 3 të tilla, të viteve të fundit. Rrjedhimisht, nuk mund të konfirmohet kushti i periodicitetit. Në RVB sillet si referencë për përfshirjen e raportit të NjBSVC në hartimin e RVB-së, dok. nr. 34, që është sondazhi i kryer me studentët nga Zyra e statistikës. Sikurse theksuar më lart, ky raport është firmosur nga drejtuesi i kësaj zyre që nuk është pjesë e NjSBVC dhe nga ana përmbajtjesore, ky raport nuk përmban analiza, konkluzione apo rekomandime lidhur me cilësinë, por thjesht statistika përshkruese (mesatare) për perceptimin e studentëve lidhur me aspekte të ndryshme, mësimore, didaktike e administrative. <i>Nuk disponohen të dhëna ndër vite për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri. Sugjerohet kryerja periodike dhe rigoroze e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit nga ana e NjSBC.</i>
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës	Në raportin e vetëm të NjBSC, rubrika e metodologjisë përmend, pa referenca, pyetësorët me studentët, intervistat me stafin akademik dhe studimin e dokumentacionit. Në këtë dokument përshkruhen 11 indikatorë të përdorur për vlerësimin e studentëve të programit. Përgjithësisht metoda e përdorur synon nxjerrjen e peshave kundrejt

<p>akademike të programit të studimit.</p>	<p>totalit të asaj që synon të masë indikatorin, pra një lloj <i>analize statike raportesh</i>. Në fq. 14 të raportit jepet një tabelë që shpreh korrelacionin midis notës mesatare të studentit në shkollën e mesme dhe notës mesatare në universitet, po pa shpjeguar nëse është bërë një analizë regresioni për këtë qëllim apo është thjesht një filtrim në Excel i të dhënave. Në dok. nr. 34, vlerësimi përmend pyetësorët për mbledhjen e të dhënave dhe më pas janë nxjerrë mesataret për të vlerësuar performancën e indikatorit në shqyrtim. Në një rast, në fillim të dokumentit përmendet edhe devijimi standard i të dhënave, si një statistikë përshkruuese që kërkon vëmendje, por në material nuk shtjellohen analiza për këtë tregues.</p> <p>Për sa më lart, metodat dhe instrumentet e përdorura janë bazike dhe deri diku të kënaqshme. Mund të bëhen analiza më të thelluara, përmes teknikave më të sofistikuara, për të nxjerrë konkluzione më të dobishme. Parametrat që përmenden si indikatorë, duhen shtjelluar konkretisht se çfarë kanë matur dhe si janë përdorur.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për kërkesat e këtij kriteri, në dokumentet e depozituara, nuk gjenden të dhëna, përveç sa përshkruar më lart. Pa kaluar në përsëritje, nuk ka gjurmë të vlerësimit të kurrikulës, të mësuarit, vlerësim paralel të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve, praktikës, testime lokale, etj.</p> <p><i>Sugjerohet që, në përmbushje të kërkesave të këtij kriteri, institucioni të përdorë dhe bëjë të aksesueshëm, vlerësimin e aspekteve të ndryshme të performancës mësimdhënëse e mësimnxënëse.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e</p>	<p>Sikurse theksuar në kriterin 2 më lart, subjekti përdor pyetësorë e anketime për vjeljen e mendimeve të stafit akademik dhe të studentëve, sa i përket vlerësimit të dijeve dhe kompetencave të përfituara nga programi. Lidhur me punëdhënësit dhe institucionet e tjera, nga dokumentacioni i depozituar në ASCAL, konstatohen sondazhe me të diplomuarit, sikurse edhe takime Alumni.</p>

institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në përputhje me Ligjin 80/2015 (neni 103), VKM nr. 531, dt. 11.09.2018 (Kodi i Cilësisë), Statutin institucional, si edhe duke iu referuar Rregullores së NjBSVC konstatohet se është ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe janë parashikuar rregullat e procedurat për funksionimin e saj. Në Planin strategjik institucional nuk identifikohen politika konkrete lidhur me cilësinë. Në përbërje të NjBSVC është përfshirë një ekspert i jashtëm, sikurse 4 aktorë të brendshëm: një student dhe 3 staf akademik. Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucioneve, por në dosje nuk u depozituan dokumentet konkrete të këtyre marrëveshjeve, për të konkluduar mbi angazhimin e aktorëve të jashtëm në cilësi.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rregullorja e NjBSVC parashtrohet detyrat për strukturat e përfshira në garantimin e brendshëm të cilësisë. Përgjithësisht rregullat e parashikuara janë të qarta dhe konkrete. Për shkak se kjo njësi depozitoi vetëm një raport nga 3 të kërkuar minimalisht prej GVJ-së, nuk mund të konfirmohet ushtrimi me përgjegjësi i detyrave të parashtuara në rregullore.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e njësisë kryesore që ofron programin e studimit, Dekani dhe departamentet përgjegjëse për këtë program propozojnë ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme për rritjen dhe garantimin e cilësisë. Po kështu, nga sondazhi i kryer me studentët del në pah përfshirja e studentëve për përmirësimin e çështjeve që lidhen me cilësinë. Nuk mund të konfirmohet plotësisht se kjo përfshirje është e vijueshme dhe periodike, për aq kohë sa dokumentet e depozituara i referohen të dhënave për 1-2 vite akademike.

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimet me studentët, pedagogët, sikurse edhe me përfaqësues të NjSBC dhe drejtues të institucionit, nuk u konstatuan ankesa apo raportime në këtë drejtim. Njëkohësisht, nga baza dokumentare e depozituar nuk konstatohen elementë që të krijojnë dyshime për trajtim diskriminues në përfshirje dhe aktivizim sa i përket proceseve vlerësuese. Pyetësorët deklarohen se janë anonimë dhe në raportin e NjBSVC dhe Zyrës së statistikës nuk përmbahen emra në kontekst denigrues, fyes apo diskriminues.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Për kërkesat e këtij kriteri, konfirmohet prania e një eksperti të jashtëm në përbërje të NjBSVC. Në dokumentacion nuk identifikohen gjurmë të ekspertëve të tjerë në këtë proces.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga konsultimi me prezencën <i>online</i> të subjektit, konstatohet se NjSBC nuk ka një faqe të dedikuar për të, ku të jenë pasqyruar në mënyrë transparente raportet e sigurimit të cilësisë ndër vite. Edhe në RVB nuk jepen referenca konkrete për këtë kriter.</p> <p><i>Sikurse theksuar më lart, mungojnë politikat dhe strategjitë e dedikuara për cilësinë.</i></p> <p>Ndonëse në Statut dhe Rregulloren e NjBSVC specifikohet raportimi vjetor për cilësinë, institucioni nuk vuri në dispozicion të GVJ, në statusin e të interesuarit direkt për cilësinë, raportet vjetore të kërkuara.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Sikurse theksuar më lart, nuk ka publikime në këtë drejtim, për të gjykuar më pas mbi lirinë, etikën akademike dhe respektimin e legjislacionit për të dhënat personale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen</p>	<p>Nuk ekzistojnë dokumente për përmbushjen e kërkesave të këtij kriteri.</p>



me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.									
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në mungesë të një analize të thelluar dhe plani respektiv masash, nuk mund të sigurohet efektiviteti dhe impakti për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.								
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk gjenden gjurmë të veprimtarive të tilla.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Ekonomi Ndërmarrjeje”

a. Pika të forta dhe afirmime:

1. Staf i kualifikuar dhe me eksperiencë ndërkombëtare në mësidhënie;
2. Infrastrukturë bashkëkohore për lëvrimin e mësimin dhe realizimin e aktiviteteve didaktike;
3. Diplomë e dyfishitë, e njohur ndërkombëtarisht për studentët;
4. Laboratorët për programin e studimit janë të pajisur shumë mirë;

b. Pika të dobta:

1. Plotësim jo korrekt i dokumentacionit, sipas normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor, dhe nuk ishte i azhurnuar dhe nganjëherë mungonte;
2. Mungesë raportimi periodik për cilësinë dhe analizim bazik i të dhënave për studentët përgjatë arsimimit dhe pas diplomimit;

3. Studim tregu i paplotë dhe i padetajuar për të kuptuar konkurrencën dhe ndërtuar strategjinë e duhur të menaxhimit dhe arsimimit për segmentin e synuar të studentëve;
4. Plan strategjik i pazbërthyer në objektiva SMART dhe i pamarkuar me strukturën përgjegjëse për arritjen e objektivit, alokimin e buxhetit dhe formën e raportimit për programin në shqyrtim;
5. Mungesa e transparencës në dorëzimin e dokumenteve financiare tek vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, duke mos zbuluar si proceset e financimit dhe investimit ndihmojnë dhe përmirësojnë programin e studimit;

Rekomandime:

1. Dokumentet që mbështesin proceset rregullatore brenda Institucionit duhet të korrigjohen dhe përmirësohen;
2. GVJ rekomandon që Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë duhet të jetë më e përgjegjshme në kryerjen e detyrave të saj, siç specifikohet në dokumente të ndryshme institucionale. Kjo njësi duhet të kryejë vlerësime vjetore dhe të raportojë rregullisht, jo në mënyrë sporadike duhet të ketë tregues të qartë dhe të shtuar të vlerës së performancës dhe të jetë transparent duke publikuar raportin e tij në faqen e Fakultetit dhe kanaleve të tjera, në mënyrë që të bëjë cilësinë motorin drejtues për suksesin institucional;
3. Të bëhen studime tregu më të plota për të kuptuar konkurrencën, identifikuar avantazhet e disavantazhet dhe rritur shanset për sukses;
4. Të rritet transparenca e planeve financiare dhe të përcaktohen prioritetet për alokim fondesh, në përputhje me prioritetet akademike dhe ato administrative;
5. Të tregohet kujdes në plotësimin, përditësimin dhe bërjen transparent të informacioneve, në të gjitha hallkat e proceseve që përfshin cilësia;

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor study program in "Enterprise Economics"

a. Strengths and affirmations:

1. Deeply and widely qualified and internationally recognized academic staff;
2. Modern infrastructure to conduct and develop didactic activities and lectures;
3. Double diploma for students, internationally recognized and valued;
4. The laboratories for the study program are very well equipped;

b. Weaknesses:

1. Documentation is, for the most part, not completed according to the specified technical and professional norms, and was not up to date and sometimes lacking;
2. Sporadic reporting on internal quality assurance and basic data analysis on students' progress during and after the study program;

3. There is no proper market research regarding the needs of this study program, in order to fully and correctly understand the niche this program aims to fill and therefore to design and implement a vision in line with the actual and forthcoming conditions;
4. Strategic plan not broken down into SMART tactical and operational objectives, unmarked with the responsible unit to manage the objective, allocate the budget and report back on its achievement;
5. Lack of transparency in delivering the financial documents to external quality evaluators thusly not disclosing how the funding and investing processes assist and improve the study program;

Recommendations

1. EEG recommends that the documents supporting the regulatory processes within BUC should be corrected and improved;
2. EEG recommends the Internal Quality Assurance Unit must be more responsible in carrying out its duties, as specified in various institutional documents. This unit must conduct yearly assessments and report back regularly, not sporadically; must have clear and value-adding performance indicators and be transparent by publishing its report on the Faculty web page and other channels, so as to make quality the driving engine for institutional success;
3. EEG strongly recommends the institution should carry out its own primary market research, so as to properly comprehend the competitors, identify its advantages and disadvantages and improve its chances for success;
4. EEG recommends more transparency on financial plans, as well as stating the priorities on funds allocation in line with academic and administrative objectives;
5. EEG recommends carefully completion, updating and making transparent of the information, in all links of processes of the quality assurance;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

